



FORCAT E ARMATOSURA NË VIJËN E PARË

për përballimin e përmytjeve, angazhim maksimal në mbrojtje të jetës dhe pronës

» faqe 3



NJËSIA SPECIALE "DELTA FORCE" EVAKUON BANORËT E NOVOSELËS PAS PËRMBYTJEVE MASIVE

Situata e krijuar nga përmytjet e ditëve të fundit në zonën e Novoselës, në qarkun e Vlorës, ka detyruar autoritetet të ndërmarrin masa emergjente për shpëtimin dhe evakuimin e banorëve të prekur. Pas rritjes së nivelit të ujit dhe daljes së lumit Vjosa nga shtrati, njësi speciale "Delta Force" ka nisur operacionin e evakuimit, duke u ardhur në ndihmë dhjetëra familjeve...

faqe 2



GRADIMI, NJË HAP I RI PËRGJEGJËSIE DHE LIDERSHIPI NË AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA

Në mjediset solemne të Akademisë së Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia e gradimit të nënoficerëve dhe oficerëve, një moment i rëndësishëm në jetën profesionale të ushtarakëve dhe në vazhdimësinë e forcimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ky akt përfaqëson jo vetëm një arritje personale për secilin prej tyre, por edhe një angazhim më të madh...

faqe 5



FLOTILJA USHTARAKE NË RRUGËTIMIN E SAJ 61-VJEÇAR MBI UJËRAT SHQIPTARE

Historia e Forcave Detare Shqiptare është e lidhur ngushtë me zhvillimet politike, ushtarake dhe strategjike të shtetit shqiptar. Një vend të veçantë në këtë histori zë Baza Detare e Durrësit, e cila, më 5 janar 1965, u rikrijua zyrtarisht, duke shënuar një etapë të re në mbrojtjen e ujërave territoriale të vendit. Në fund të vitit 1964, Këshilli i Mbrojtjes i asaj kohe mori vendimin...

faqe 12



Situata e krijuar nga përmbytjet e ditëve të fundit në zonën e Novoselës, në qarkun e Vlorës, ka detyruar autoritetet të ndërmarrin masa emergjente për shpëtimin dhe evakuimin e banorëve të prekur. Pas rritjes së nivelit të ujit dhe daljes së lumit Vjosa nga shtrati, njësia speciale “Delta Force” ka nisur operacionin e evakuimit, duke u ardhur në ndihmë dhjetëra familjeve të bllokuara nga uji.

Efektivët e kësaj njësie kanë operuar në kushte të vështira terreni, duke përdorur gomone dhe varka për të arritur në zonat më të izoluar, ku qarkullimi me automjete është bërë pothuajse i pamundur. Hapësira të tëra toke janë mbuluar nga uji, ndërsa banesat dhe infrastruktura bujqësore kanë pësuar dëme të konsiderueshme.

Operacioni i evakuimit është zhvilluar në koordinim me strukturat e Policisë së Shtetit dhe shërbimet e emergjencës, ndërsa prioritet kanë qenë të moshuarit, fëmijët dhe familjet në rrezik të drejtpërdrejtë. Efektivët e “Delta Force”, të pajisur me mjete dhe pajisje të posaçme, kanë demonstruar profesionalizëm dhe gatishmëri të lartë, duke garantuar sigurinë e banorëve gjatë transferimit në zona më të sigurta.

Sipas të dhënave nga terreni, niveli i ujit u rrit ndjeshëm gjatë ditës së sotme, duke përqësuar situatën në Novoselë dhe fshatrat përreth. Dalja e Vjosës nga shtrati ka shkaktuar një situatë kritike, e cila konsiderohet një nga përmbytjet më të rënda të viteve të fundit në këtë zonë.

Forcat në terren vijojnë monitorimin e situatës dhe janë në gatishmëri për ndërhyrje të mëtejshme, ndërsa institucionet përgjegjëse po vlerësojnë dëmet dhe po koordinojnë ndihmën për banorët e prekur. Angazhimi i strukturave speciale dhe forcave të sigurisë mbetet jetik për përballimin e kësaj emergjence dhe për mbrojtjen e jetës së qytetarëve.

Njësia speciale “Delta Force” evakuon banorët e Novoselës pas përmbytjeve masive



Kursantët e QAPN/ANO realizojnë marshim stërvitor 24 km drejt Liqenit të Bovillës

Në zbatim të planit mësimor-stërvitor, kursantët e Kursit Bazë dhe Kursit të Avancuar të Nënoficerëve, në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve (QAPN/ANO) Zall-Herr, zhvilluan me sukses një marshim stërvitor në distancën 24 kilometra. Marshimi u realizua sipas itinerarit të miratuar Garnizoni Zall-Herr – Liqeni i Bovillës, duke u zhvilluar në kushte reale terreni dhe duke kërkuar përpjekje fizike, përqendrim dhe disiplinë të lartë nga të gjithë pjesëmarrësit. Aktiviteti kishte si qëllim kryesor rritjen e qëndrueshmërisë fizike, forcimin e frymës së bashkëpunimit, si dhe konsolidimin e aftësive profesionale dhe ushtarake të kursantëve. Gjatë marshimit, kursantët demonstuan nivel të lartë përgatitjeje, korrektësi në zbatimin e urdhrave dhe disiplinë shembullore, duke reflektuar standardet e trajnimit që ofron QAPN/ANO. Aktiviteti shërbeu gjithashtu si një element i rëndësishëm vlerësimi i kapaciteteve individuale dhe kolektive, në funksion të përgatitjes së nënoficerëve të ardhshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Marshime të tilla stërvitore mbeten pjesë thelbësore e formimit ushtarak, duke kontribuar drejtpërdrejt në ndërtimin e qëndrueshmërisë fizike dhe mendore, si dhe në përgatitjen e personelit për përmbushjen e detyrave dhe misioneve në çdo situatë operacionale.



Forcat e Armatosura në vijën e parë për përballimin e përmbytjeve, angazhim maksimal në mbrojtje të jetës dhe pronës

Situata e krijuar nga reshjet intensive të ditëve të fundit ka vënë në provë kapacitetet e reagimit ndaj emergjencave në disa qarqe të vendit, ku më të prekura mbeten Shkodra, Lezha, Durrësi, Fieri, Berati, Vlora dhe Gjirokastra. Përballë kësaj gjendjeje të vështirë, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e Mbrojtjes Civile, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe autoritetet vendore, janë angazhuar në mënyrë intensive në terren, duke qenë në vijën e parë të reagimit për mbrojtjen e jetës së qytetarëve dhe minimizimin e dëmeve materiale.

Që në orët e para të përkeqësimit të situatës, njësitë të specializuara të Forcave të Armatosura janë dislokuar në zonat më problematike, duke ofruar mbështetje operative për evakuimin e banorëve, përforcimin e argjinaturave, largimin e ujërave dhe garantimin e aksesit në rrugët kryesore. Angazhimi i tyre është përqendruar kryesisht në qarqet Shkodër, Lezhë, Vlorë, Durrës, Fier dhe Gjirokastrë, aty ku rreziku për komunitetet dhe infrastrukturën ka qenë më i lartë.

Në qarkun Shkodër, efektivet e Forcave të Armatosura kanë operuar në zona të përmbytura si Oboti, Vau i Dejës dhe disa fshatra të Malësisë së Madhe, ku janë evidentuar rrugë të bllokuara, banesa të rrethuara nga uji dhe dëmtime infrastrukturore. Me mjete të tonazhit të rëndë dhe kalueshmërisë së lartë, forcat kanë garantuar transportin e banorëve dhe furnizimin me ndihma bazë, si dhe kanë asistuar strukturat vendore në monitorimin e nivelit të ujërave.

Në qarkun Lezhë, ku mijëra hektarë tokë bujqësore janë nën ujë dhe dhjetëra banesa të rrethuara, Forcat e Armatosura kanë mbështetur procesin e evakuimit të familjeve në rrezik, si dhe ndërhyrjet për riparimin dhe përforcimin e argjinaturave, veçanërisht në zonën e lumit Droje. Ndërhyrja e shpejtë ka qenë vendimtare për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të përmbytjeve.

Një nga situatat më kritike është shënuar në qarkun Vlorë, konkretisht në Novoselë, ku dalja e lumit Vjosë nga shtrati ka rritur ndjeshëm nivelin e ujit. Forcat e Armatosura, në bashkëpunim me njësitë speciale dhe strukturat e emergjencës, kanë kryer evakuime me gomone dhe motobarka shpëtimi, duke nxjerrë në siguri familje të izoluar nga uji dhe duke monitoruar vazhdimisht nivelin e lumit.

Në qarkun Durrës, ku qindra banesa dhe objekte janë përmbytur, efektivet e Forcave të Armatosura kanë qenë të angazhuar në operacione të gjera për largimin e ujit me pompa



thithëse, si dhe në strehimin e personave të evakuuar në strukturat e Forcave të Armatosura. Shtëpia e Pushimit e FA në Durrës është vënë në dispozicion për akomodimin e qindra qytetarëve, duke reflektuar rolin humanitar dhe mbështetës të ushtrisë në kohë emergjencash.

Ndërkohë, në qarkun Gjirokastrë, forcat kanë asistuar në zonat e prekura nga rrëshqitjet e dherave dhe rritja e nivelit të lumit Vjosë, duke kontribuar në sigurimin e akseve rrugore dhe mbështetjen e komuniteteve të izoluar. Angazhimi ka qenë i vazhdueshëm edhe në qarqe të tjera, ku situata paraqitet më e stabilizuar, por mbetet nën monitorim të vazhdueshëm.

Në total, në këtë operacion emergjent janë angazhuar rreth 150 efektivë të Forcave të Armatosura, mbi 20 mjete të kalueshmërisë së lartë dhe të tonazhit të rëndë, 10 gomone dhe motobarka shpëtimi, si dhe 15 pompa thithëse me kapacitete të ndryshme.

Ky dislokim forcash dhe mjeteve dëshmon gatishmërinë dhe aftësinë e Forcave të Armatosura për të reaguar shpejt dhe me profesionalizëm në situata krizash natyrore.

Krahas ndërhyrjeve operative, Forcat e Armatosura po bashkëpunojnë ngushtë me pushtetin vendor dhe strukturat e Mbrojtjes Civile për vlerësimin e dëmeve dhe planifikimin e fazës së rimëkëmbjes. Autoritetet u bëjnë thirrje qytetarëve të respektojnë udhëzimet e dhëna, të shmangin zonat e rrezikshme dhe të bashkëpunojnë me strukturat në terren, në mënyrë që të garantohet siguria e jetës dhe pronës.

Situata vijon të monitorohet në mënyrë të pandërprerë, ndërsa Forcat e Armatosura mbeten në gatishmëri të plotë për ndërhyrje të mëtejshme, duke konfirmuar edhe një herë rolin e tyre thelbësor në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë kombëtare në kohë emergjencash.



Forcat e Armatosura dhe Emergjencat Civile në gatishmëri të plotë

Shqipëria është përfshirë gjatë ditëve të fundit nga reshje intensive shiu, të cilat kanë shkaktuar rritje të niveleve të lumenjve dhe problematika serioze në disa qarqe të vendit. Situata më e vështirë paraqitet

në Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Berat dhe Gjirokastrë, ku janë evidentuar përmbytje të tokave bujqësore dhe banesave, rrëshqitje dherash, si dhe dëmtime të infrastrukturës rrugore.

Sipas të dhënave nga strukturat e emergjencave, në disa zona urbane dhe rurale ka pasur depërtim të ujit në banesa dhe bllokime të përkohshme të akseve rrugore, ndërsa qarqe të tjera mbeten nën monitorim të vazhdueshëm, pa rrezik të menjëhershëm për popullsinë.

Aktivizimi i menjëhershëm i strukturave të emergjencës

Menjëherë pas përkeqësimit të kushteve atmosferike, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka aktivizuar të gjithë mekanizmat e reagimit. Komitetet e Emergjencave Civile janë mbledhur në nivel qendror dhe vendor, duke hartuar plane konkrete veprimi për menaxhimin e situatës dhe mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve. Në qytete si Durrësi, autoritetet lokale kanë zhvilluar mbledhje të posaçme, ku është vendosur që aksioni për largimin e ujërave dhe normalizimin e situatës të vijojë pa ndërprerje, deri në zgjidhjen e plotë të problematikave për çdo familje të prekur.

Forcat e Armatosura, rol vendimtar në terren

Në përballimin e emergjencës, një rol kyç po luajnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilat janë angazhuar në vijën e parë të operacioneve të ndihmës dhe shpëtimit. Nën koordinimin e strukturave të Mbrojtjes Civile, ato po asistojnë në:

- evakuimin e banorëve nga zonat me rrezik të lartë,
- transportimin e mjeteve dhe pajisjeve të rënda,
- forcimin e argjinaturave dhe digave mbrojtëse,
- hapjen e rrugëve të bllokuara nga rrëshqitjet e dherave,
- mbështetjen e familjeve të izoluar.

Prania e Forcave të Armatosura ka garantuar reagim të shpejtë dhe eficient, duke ndikuar drejtpërdrejt në minimizimin e dëmeve dhe rritjen e sigurisë së qytetarëve.

Bashkëpunim ndërinstytucional dhe solidaritet

Menaxhimi i situatës po realizohet përmes një bashkëpunimi të ngushtë ndërinstytucional, ku krahas Forcave të Armatosura dhe Mbrojtjes Civile janë përfshirë edhe Policia e Shtetit, shërbimet zjarrfikëse, pushteti vendor dhe operatorët e shërbimeve publike.

Ky koordinim ka bërë të mundur reagimin e shpejtë në zonat më problematike dhe ka dëshmuar rëndësinë e solidaritetit institucional në përballimin e situatave emergjente.

Në monitorim të vazhdueshëm

Autoritetet bëjnë me dije se situata mbetet nën monitorim të



vazhdueshëm, ndërsa strukturat përgjegjëse janë në gatishmëri të plotë për të ndërhyrë në çdo rast nevoje. Qytetarët ftohen të respektojnë udhëzimet e autoriteteve dhe të raportojnë çdo situatë rreziku pranë strukturave përkatëse.

Angazhimi i pandërprerë i Forcave të Armatosura dhe Emergjencave Civile mbetet një garanci për përballimin e kësaj situatë dhe për rikthimin sa më të shpejtë të normalitetit në zonat e prekura.





Në mjediset solemne të Akademisë së Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia e gradimit të nënoficerëve dhe oficerëve, një moment i rëndësishëm në jetën profesionale të ushtarakëve dhe në vazhdimësinë e forcimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ky akt përfaqëson jo vetëm një arritje personale për secilin prej tyre, por edhe një angazhim më të madh në shërbim të vendit, të sigurisë dhe të interesit kombëtar.

Ceremonia u zhvillua në prani të drejtuesve të lartë të Forcave të Armatosura, autoriteteve të Akademisë, instruktorëve, familjarëve dhe të ftuarve, duke krijuar një atmosferë dinjtoze dhe motivuese për të gjithë pjesëmarrësit. Gradimi shënoi kulmin e një rrugë të gjatë përgatitjeje akademike, profesionale dhe morale, të ndërtuar mbi disiplinën, sakrificën dhe vendime të vështira që formësojnë karakterin e ushtarakut. Në fjalët e mbajtura gjatë ceremonisë, u theksua se grada nuk është thjesht një simbol autoriteti, por mbi të gjitha një barrë përgjegjësie. Ajo kërkon shembull personal, aftësi udhëheqëse dhe përkushtim të palëkundur ndaj misionit dhe vlerave të Forcave të Armatosura. Oficerët dhe nënoficerët e graduar u inkurajuan që të jenë liderë të drejtë, profesionistë të përgatitur dhe shërbëtorë të devotshëm të atdheut. Në sytë e të graduarve dallohej qartë krenaria për arritjen e sotme, por edhe vetëdija se nga kjo ditë e tutje çdo vendim dhe çdo veprim do të ketë peshë më të madhe. Grada e re nuk përfaqëson vetëm avancim në karrierë, por një angazhim të ri për të udhëhequr vartësit me ndershmëri, për të mbrojtur interesat e vendit dhe për të vepruar me profesionalizëm në çdo situatë, brenda dhe jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Akademia e Forcave të Armatosura vijon të mbetet institucioni kryesor i formimit të elitës ushtarake shqiptare, duke përgatitur kuadro të afta për t'u përballur me sfidat bashkëkohore të sigurisë. Programet e saj mësimore synojnë jo vetëm zhvillimin e aftësive taktike dhe teknike, por edhe edukimin me vlerat e lidershit,



Gradimi, një hap i ri përgjegjësie dhe lidershipi në Akademinë e Forcave të Armatosura

përgjegjësisë dhe bashkëpunimit ndërinstitucional e ndërkombëtar. Ceremonia e gradimit ishte gjithashtu një moment reflektimi për rrugën e përbashkët të Forcave të Armatosura drejt modernizimit dhe përmbytjes së detyrimeve në kuadër të NATO-s. Oficerët dhe nënoficerët e rinj në gradë do të jenë pjesë aktive e këtij procesi, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve operacionale dhe në përforcimin e rolit të Shqipërisë si faktor stabiliteti në

rajon. Në përfundim të ceremonisë, u përcollën urime për të gjithë të graduarit, me bindjen se besimi i dhënë sot do të shndërrohet në shërbim të ndershëm, profesionalizëm dhe përkushtim të vazhdueshëm. Gradimi i sotëm nuk është fundi i një etape, por fillimi i një përgjegjësie më të madhe për të udhëhequr, për të mbrojtur dhe për t'i shërbyer vendit me dinjitet dhe besnikëri ndaj flamurit.

Forcat e Armatosura përmirësojnë infrastrukturën: Përfundon ura metalike në Bleran

Batalioni i Xhenios në Komandën Mbështetëse vijon me intensitet detyrën për ndërtimin e urës metalike tip “Bailey” në fshatin Bleran, bashkia Shkodër.

Ura, me gjatësi 13 metra dhe seksion 1/1, ka një kapacitet mbajtës deri në 30 tonë dhe përfaqëson një investim të rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës lokale. Ndërtimi i saj do të ndikojë drejtpërdrejt në lehtësimin e lëvizjes dhe rritjen e aksesit për rreth 1 000 banorë të zonës, duke përmirësuar ndjeshëm kryerjen e aktiviteteve të përditshme ekonomike dhe sociale.

Ky angazhim i Forcave të Armatosura dëshmon edhe një herë rolin e tyre të rëndësishëm në mbështetje të komuniteteve dhe në përballimin e nevojave infrastrukturore, veçanërisht në zonat rurale. Ndërtimi i urës pritet të përfundojë brenda afateve të planifikuara, duke garantuar standarde të larta sigurie dhe funksionaliteti.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Më 5 janar të vitit 1555, në një kohë errësire për fatin politik të shqiptarëve, por jo për shpirtin e tyre, prifti katolik Gjon Buzuku përfundoi së shkruari veprën që do të shënonte fillimin e dokumentuar të gjuhës shqipe të shkruar: *Mesharin*. Kanë kaluar plot **471 vite** nga ajo ditë historike, por pesha e saj nuk është zbehur, përkundrazi, ajo rritet çdo vit, sepse *Meshari* nuk është thjesht një libër fetar, është **akt vetëdijeje kombëtare, rezistencë kulturore dhe dëshmi e hershme e dashurisë për gjuhën shqipe**.

Në parathënien e tij, Buzuku shkruan me një ndjenjë urgjence dhe përgjegjësie se besimtarët shqiptarë kishin nevojë të dëgjonin dhe të kremtonin fjalën e Zotit në gjuhën e tyre. Kjo fjali, e thënë në shekullin XVI, tingëllon sot si një manifest për të drejtën themelore të një populli: **të flasë, të besojë, të mendojë dhe të shkruajë në gjuhën e vet**.

Meshari, më shumë se një libër

Meshari është shkruar në një kohë kur trojet shqiptare ishin nën sundimin osman, kur institucionet shtetërore shqiptare nuk ekzistonin dhe kur rreziku i asimilimit kulturor ishte real. Pikërisht në këtë kontekst, vendimi i Gjon Buzukut për të shkruar në shqip merr përmasa historike.

Ai nuk shkroi në latinisht, gjuhën zyrtare të Kishës, as në ndonjë gjuhë tjetër të kohës. Ai zgjodhi shqipen një gjuhë që nuk kishte ende traditë të konsoliduar shkrimi, por që jetonte fuqishëm në gojën dhe shpirtin e popullit. Ky akt e bën Buzukun jo vetëm një prift, por **një ndër figurat e para të Rilindjes kulturore shqiptare**, shumë shekuj përpara Rilindjes Kombëtare të shekullit XIX.

Meshari është mishërim i përpjekjes për të ruajtur **identitetin kombëtar dhe shpirtëror**. Ai dëshmon se gjuha shqipe ishte jo vetëm mjet komunikimi, por edhe mjet besimi, kulture dhe vetëdijeje.

Gjuha si shtyllë e qëndresës

Historia shqiptare ka treguar vazhdimisht se gjuha ka qenë arma jonë më e fortë. Kur mungonin ushtritë, institucionet dhe shteti, fjala shqipe mbajti gjallë kombin. Nga Buzuku te Bogdani, nga Frashërit te Fishta, nga rilindësit te shkrimtarët modernë gjuha ka qenë fije lidhëse e brezave.


Në këtë këndvështrim, *Meshari* është pika zero e kësaj rruge. Ai është dëshmia se shqiptarët e shekullit XVI e kuptonin rëndësinë jetike të gjuhës amtare. Nuk është rastësi që sot, kur flasim për sigurinë kombëtare, për qëndrueshmërinë e shtetit dhe për identitetin tonë në një botë globale, gjuha mbetet një nga elementët kryesorë.

Për një gazetë si **“Ushtria”**, kjo datë merr një domethënie të veçantë. Ushtria mbron territorin dhe sovranitetin, por kultura dhe gjuha mbrojnë **thelbin e kombit**. Pa gjuhë, nuk ka atdhe të plotë.

Nga Vatikani në Tiranë, simbolika e ruajtjes

Fakti që i vetmi ekzemplar origjinal i *Mesharit* ruhet në Bibliotekën e Vatikanit është një kujtesë e fortë për historinë tonë të vështirë. Megjithatë, gjesti i

Janar 1555, Meshari i Gjon Buzukut: Guri themeltar i fjalës shqipe dhe i identitetit tonë kombëtar



Meshari është shkruar në një kohë kur trojet shqiptare ishin nën sundimin osman, kur institucionet shtetërore shqiptare nuk ekzistonin dhe kur rreziku i asimilimit kulturor ishte real. Pikërisht në këtë kontekst, vendimi i Gjon Buzukut për të shkruar në shqip merr përmasa historike.

Papa Françeskut, i cili solli një kopje të *Mesharit* gjatë vizitës së tij në Tiranë në vitin 2014, dhe ekspozimi i saj në Bibliotekën Kombëtare, përbën një akt simbolik me vlerë të madhe.

Ai akt nuk ishte thjesht protokollar. Ishte një njohje ndërkombëtare e rëndësisë së gjuhës shqipe dhe e rolit të saj në qytetërimin evropian. *Meshari* është provë se shqiptarët kanë qenë pjesë e Evropës kulturore shumë përpara se kjo të bëhej një synim politik.

Çfarë na thotë Buzuku sot?

Në një kohë kur globalizimi, teknologjia dhe rrjetet sociale po ndikojnë fort mbi mënyrën se si flasim dhe shkruajmë, mesazhi i Gjon Buzukut është më aktual se kurrë. Sot, rreziku nuk është ndalimi i gjuhës shqipe, por varfërimi i saj, deformimi dhe përdorimi i pakujdesshëm.

Shkrimi në shqip sot është akt përgjegjësie. Është respekt për historinë, për sakrificat e brezave dhe për

ata që, si Buzuku, zgjodhën rrugën më të vështirë për të mbajtur gjallë fjalën shqipe. Çdo tekst i shkruar me kujdes, çdo libër, çdo artikull, çdo dokument zyrtar në shqip është vazhdim i asaj tradite 471-vjeçare.

Një trashëgimi që kërkon përkujdesje

Përvjetorë si ky nuk duhet të mbeten vetëm data kalendarike. Ato duhet të shërbejnë si momente reflektimi dhe veprimi. Institucionet arsimore, kulturore kanë detyrimin të promovojnë gjuhën shqipe, historinë e saj dhe figurat që e ndërtuan.

Meshari i Gjon Buzukut nuk është relike muzeale. Ai është **gur themeli**. Është dëshmi se identiteti shqiptar është ndërtuar mbi fjalën, mbi besimin dhe mbi qëndresën kulturore.

Sot, pas 471 vitesh, nderimi më i madh që mund t'i bëjmë Gjon Buzukut nuk është vetëm ta kujtojmë, por **ta vazhdojmë misionin e tij**: të shkruajmë, të mendojmë dhe të jetojmë në shqip, me dinjitet, përgjegjësi dhe krenari.

“BIG BROTHER”: Eksperiment social apo pasqyrë e zhveshur e shoqërisë sonë?

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Prej vitesh, *Big Brother* nuk është më thjesht një format televiziv argëtues. Ai është shndërruar në një **fenomen social**, një hapësirë ku shfaqen pa filtra tensionet, kontradiktat, ambiciet, frustrimet dhe mentaliteti i shoqërisë

moderne shqiptare. Pyetja që lind natyrshëm nuk është më “a na pëlqen apo jo?”, por: **Çfarë na tregon “Big Brother” për ne si shoqëri?** A është një eksperiment social i qëllimshëm apo thjesht një panoramë brutale e përditshmërisë sonë?

Nga format televiziv në laborator shoqëror

Në thelb, *Big Brother* funksionon si një laborator social: individë të ndryshëm, të mbyllur në një hapësirë të kufizuar, nën presion të vazhdueshëm, të vëzhguar 24 orë në ditë. Këto kushte nuk janë artificiale vetëm për spektakël; ato prodhojnë sjellje reale, shpesh të zhveshura nga maskat shoqërore që individët mbajnë në jetën e përditshme.

Sociologë dhe studiues të mediave e kanë theksuar se *reality show-t* nuk krijojnë sjellje nga hiçi, por **përforcojnë dhe ekspozojnë modele ekzistuese**. Në këtë kuptim, *Big Brother* nuk “na prish”, por na tregon se çfarë jemi – ose çfarë po bëhemi.

Gjuha: Pasqyra më e drejtpërdrejtë e degradimit shoqëror

Një nga elementët më problematikë dhe më të dukshëm është gjuha e përdorur. Fjalori i varfër, banaliteti, agresiviteti verbal, normalizimi i fyerjes dhe vulgaritetit janë kthyer në elemente të zakonshme të diskursit brenda shtëpisë – dhe përmes ekranit, edhe jashtë saj.

Gjuha nuk është thjesht mjet komunikimi; ajo është **pasqyrë e mendimit**. Kur gjuha varfërohet, varfërohet edhe mënyra e të menduarit. Kur fyerja bëhet normë, dialogu vdes. *Big Brother* e nxjerr këtë problem në pah në mënyrë brutale: konfliktet nuk zgjidhen me argumente, por me britma, etiketime dhe dhunë verbale.

Shqetësues është fakti se kjo gjuhë jo vetëm tolerohet, por shpesh **shpërblehet me vëmendje, famë dhe vota publiku**.

Normalizimi i konfliktit dhe kultura e përplasjes

Një tjetër element i fortë është kultura e konfliktit. Debat i qetë, mendimi i arsyetuar dhe dialogu konstruktiv janë pothuajse të padukshëm. Në vend të tyre, dominojnë:

- **polarizimi ekstrem,**
- **ndarja “ne kundër atyre”,**
- **dramatizimi i çdo situatë,**
- **viktimizimi ose agresiviteti i tepruar.**

Kjo nuk është vetëm logjikë televizive. Është një pasqyrë e diskursit publik shqiptar: në politikë, në rrjete sociale, në media, madje edhe në familje. *Big Brother* e amplifikon këtë realitet, por nuk e shpik.

Fama pa meritë dhe modeli i suksesit të shpejtë

Një nga mesazhet më të rrezikshme që përçohet është ideja se fama është qëllim në vetvete, jo rezultat i punës, dijes apo vlerave. Të bëhesh i njohur “me çdo kusht” shihet si sukses.



Kjo krijon një model të rremë për të rinjtë:

- më mirë të jesh kontrovers sesa i ditur;
 - më mirë të bësh zhurmë sesa të kesh përmbajtje;
 - më mirë të provokosh sesa të ndërtohet.
- Shoqëria që ushqen këto modele rrezikon të humbasë respektin për punën, dijen dhe meritokracinë.

A është Big Brother pasqyrë e përditshmërisë sonë?

Në shumë aspekte, po.

Ai pasqyron:

- **tensionin social;**
- **mungesën e dialogut;**
- **krizën e komunikimit;**
- **etjen për vëmendje;**
- **frustrimet e akumuluar.**

Por është edhe një **pasqyrë e shtrembëruar**, sepse përzgjedh, monton dhe thekson ekstremet. Megjithatë, fakti që publiku identifikohet, reagon emocionalisht dhe përfshihet masivisht, tregon se këto sjellje nuk janë të huaja për shoqërinë.

Roli i publikut: Bashkëpërgjegjësi morale

Big Brother nuk do të kishte fuqi pa publikun. Çdo klikim, votë, koment dhe debat në rrjete sociale e ushqen këtë fenomen. Publiku nuk është vetëm spektator; ai është aktor pasiv, por i fuqishëm.

Kjo ngre pyetje të rëndësishme:

- **Çfarë vlerësojmë ne si shoqëri?**
- **Çfarë shpërblejmë me vëmendje?**
- **Çfarë modelesh duam të shohim?**

Nëse shpërblejmë konfliktin, do të kemi më shumë konflikt. Nëse shpërblejmë vulgaritetin, ai do të normalizohet.

Çfarë duhet të ndryshojmë?

Së pari, gjuhën. Duhet të rikthejmë respektin për fjalën, për debatin dhe për komunikimin e shëndetshëm. Media ka përgjegjësi të madhe, por edhe publiku duhet të refuzojë normalizimin e dhunës verbale.

Së dyti, **modelet që promovojmë**. Shoqëria ka nevojë për figura që përfaqësojnë:

- **integritet**
- **punë**
- **dije**
- **etikë**

Së treti, **edukimin mediatik**. Qytetarët duhet të mësojnë të dallojnë mes realitetit dhe spektaklit, mes vlerës dhe zhurmës.

Big Brother si alarm shoqëror

Nëse shihet vetëm si argëtim, *Big Brother* është i rrezikshëm. Nëse shihet si alarm, mund të jetë i dobishëm. Ai na detyron të përballemi me veten, pa makijazh, pa justifikime.

Pyetja nuk është nëse *Big Brother* duhet të ekzistojë, por: **A do të mësojmë diçka nga ajo që na tregon?**

Një shoqëri e pjekur nuk i mbyll sytë pas pasqyrës. Ajo reflekton, korrigjon dhe ec përpara. Në këtë kuptim, *Big Brother* mund të jetë ose simptomë e krizës sonë kulturore, ose pikënisje për një debat serioz mbi vlerat, gjuhën dhe drejtimin që po marrim.

Zgjedhja, në fund, nuk është e televizionit. Është e jona.



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Vlora e flamurit me shkëlqimin vezullues të vajzave partizane

Nëse kërkojmë në kujtesën historike të mbi tetë dekadave më parë e deri më sot për vajzat e gratë vlonjate është një emër i shquar Cia Mandro, që edhe pse ishte e thjeshtë, nuk e donte bujën, nuk i pëlqente mburrjet e vlerësimet, ishte ajo që në fakt kishte përmbushur denjësisht detyrën ndaj Atdheut në kohët më të rrezikuara të pushtimit nazifashist. Emri i saj ndrin në emrat e luftëtarëve që shkruan epope lirie e çlirimi në librat e Luftës së madhe antifashiste Nacionalçlirimtare dhe që i shërbyen denjësisht Shqipërisë. Është fakt se vajzat dhe gratë shqiptare gjatë luftës antifashiste u bënë faktor në historinë kombëtare të shqiptarëve. Gratë shqiptare përgjatë shekujve të mbijetesës nga pushtuesit kanë luftuar krah për krah vëllezërve, luftëtarëve të lirisë dhe kanë qenë burim frymëzimi për trimëri nëpër breza. Në djepet vlonjate, të Labërisë dhe mbarë Shqipërisë janë përkundur trimëresha, heroïna, janë përkundur ëndrrat e lirisë së truallit arbëror. Gratë shqiptare që shkruan lavdi me gjakun e tyre janë të shumta në të gjitha betejat, por veçanërisht përgjatë LANÇ-it në rreshtat partizane u rreshtuan qindra gra e vajza në formacionet luftarake, pa llogaritur qindra mijëra të tjera që mbështetën luftën në të gjitha frontet luftarake. Heroizmi i gjashtëmijë grave dhe vajzave shqiptare u shkrua denjësisht me shkronja të arta në panteonin e kombit për heroizmin, guximin e trimërinë, për mençurinë dhe përgjakjen me nazifashizmin. Në front në përballje me ushtrinë naziste, u plagos dy herë gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare edhe Cia Mandro. Ajo ishte një ndër gjashtëmijë vajza e gra shqiptare, që luftuan direkt në vijën e zjarrit, në ballë të sulmit, krah shokëve të tyre partizanë. Disa prej vajzave e grave morën plagë dhe derdhën gjakun e tyre të bindura se e bënë për çlirimin e atdheut nga robëria nazifashiste. Disa prej tyre që i “kurseu” plumbi i armikut, lufta i rriti si luftëtare trime dhe si komanduese të formacioneve partizane. Qëndresa e tyre çuditi edhe vet hitlerianët, kur iu desh të përballej me qëndrimin e tyre edhe përpara litarit apo skuadrave të pushkatimit. Qëndrimet e Bule Naipit, Persefoni Kokëdhimës, Fato Berberit përpara litarit i dhanë vlera e shkëlqim heroizmit të vajzave dhe grave shqiptare në atë luftë. Lufta çlirimtare pati shumë gjak të derdhur, shumë dëshmore dhe 13 heroïna të popullit si Mine Peza, Margarita Tutulani, Inajete Duma, Qeriba Derri, Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Nimete Progonati, Penelopi Piro, Zonja Çurre, Fato Berberi, Hibe Palikuqi, Liri Gero dhe Ylberë Bilibashi që janë sot në panteonin e heroizmit shqiptar, në kursorin e lavdisë të asaj lufte vitale partizane. Vajza vlonjate Cia Mandro doli partizane bashkë me të vëllain Dhimitrin e vendosur dhe krenare për ndërmarrjen më të vështirë të jetës, mori dy plagë lufte por që u mundësua që të shpëtonte nga vdekja, edhe me mbështetjen e Shtabit Aleat të Mesdheut në Itali. Ajo ishte e bindur në idealet për çlirim edhe kur kishte humbur shumë gjak u transportua përtej Adriatikut në Bari, përmes një shtegu të vështirë dhe jashtëzakonisht kompleks, në kushtet kur bregdeti dhe portet ishin të zaptuara nga pushtuesit gjermanë. Transportimi është bërë nga shpella e famshme e Karaburunit, që ishte në zotërim të forcave aleate si një pikë strategjike e linjës së komunikimit me Shtabin Aleat të Mesdheut, ku në fakt janë mjekuar dhjetëra partizanë të plagosur rëndë dhe që kanë shpëtuar nga kthetrat e plagëve të rënda të luftës.

Të lindur në Vlorën e flamurit, të pavarësisë, të vatrës atdhetare të shqiptarizmës

Vlora e flamurit, e shpalljes së Pavarësisë, e simbolikës së qëndresës dhe mbijetesës ndaj pushtimeve ishte në ballë edhe në luftën e madhe antifashiste. Bijtë e bijat e saj shkruan epope mençurie dhe trimërie përballë fashizmit italian që më 1920-tën e kishin hedhur një herë në det baballarët dhe gjyshërit e tyre. Kështu u krijuan në Vlorë bazat e sigurta antifashiste sikurse janë të dokumentuara, që shkojnë në më shumë se 350 shtëpi baza lufte, nga të cilat po përmendim disa prej tyre Familja Bule Imami, Fadil Dauti, Xhavit e Qemal Mehmeti, Jani dhe Aspasi Mandro, Shaqo e Toli Arapi, Mitat e Lef Sallata, Shefqet Veshi, Shefqet Cenko, Ervehe Gorishti, Hyrie Drenova nëna e tre vajzave partizane të Ylvies, Hanës dhe Faries, Stoli e Sali Bahaj, Teme Alushi, Bexhet Zyberi, Petrit Bisha, Ruhije Zahaj, Ymer Picari, Shefqet Resuli, Hajro Çakërri, Emine Çela, Faik Imeraj, Namik Xhafa, Osmën Xhemali, Sezai Agalliu, Rexhep e Nuri Arapi nga ku kanë dalë nëntë partizanë, Hamza Xhuka nga



Peja, që i dha luftës 4 partizanë e partizane, Dushan Aliko, Riza Taushani, Xhevit e Qemal Malaj Zyra Radhima, Hasan Doçi, Dalip Sako dhe shumë të tjera. Gjeneral Rrahman Parllaku në librin “Mirënjohje familjeve vlonjate, që më mbajtën si birin e tyre”, Tiranë, 2007, faqe 158-159 shkruan: “..nga kujtimet me familjen e Jani dhe Aspasi Mandros. Xha Jani, bashkë me një ortak merrej me tregëti. Familja e tij bënte një jetë qytetare të rregullt, edukonte e shkollonte tre djem dhe një vajzë, Kristaqin, Dhimitrin, Pandin dhe Cien. Nënë Aspasia kur ishte martuar me Xha Janin, më të voglin e fëmijëve kishin Pandin pasi sipas radhës në oxhakun “Mandro” kishin lindur: Kristaqi më 1918, Dhimitri më 1921, Anastasia (Cia) më 1923 dhe Pandi më 1926. Kjo familje jetonte në harmoni të plotë. Nënë Aspasia të katër fëmijët i kishte në luftë, por kujdes të veçantë tregonte për vajzën Cien. Familja e xha Janit ishte streha e përhershme e njësiteve guerile”. Bazat e LANÇ-it janë plotësisht të dokumentuara tek Muzeu historik i luftës në Vlorë. Shtëpia e Jani Mandros ishte me dy kate, ndërsa kati i dytë shërbente si bazë ku përgatiteshin komunikatat dhe thirrjet për luftë kundër fashizmit, ishte bazë e sigurt e njësiteve guerile, ndërkohë që shumë shtëpi fqinje të lagjes”. Në fillim të vitit 1942 u krijuan dy njësite guerile që ishin skelet i ushtrisë së ardhshme të çetave partizane. I pari me Arif Haskon, “Patrioti” dhe pjesëtar Et’hem Gjinushi “Goliku”, Vehbi Hoxha, Koço Kllapi, Shyqyri Alimerko, Teli Ndini, Rrahman Parllaku, Dhimitër Mandro; ndërsa i dyti, i rinisë me përgjegjës Hito Çako, Babaçe Faiku, Ismet Çakërri, Fadil Dauti, Hidai Bejo, Kristaq Çali, Shaqo Arapi, Hajredin Bylyshi, Mumin Selami, Barjam Tushi, Hiqmet Buzi. Organizimi i parë i demonstratës së bukës ishte më 9.3.1942, që udhëhiqej nga Komiteti Qarkor i Vlorës dhe Hysni Kapo. Si në gjithë luftërat për liri edhe gjatë LANÇ-it Vlora, bijtë dhe bijat e saj i dhanë impulse të fuqishme lirie si një ndër trevat më të përgjakshme të vendit, ku në tërësi Zona e Parë Operative me aktivitet në mbi 6000 km² ka dëshmorët më të shumtë të rënë në luftë për çlirim, prandaj dëshmorët dhe gjithë antifashistët që rrokën armët gjatë LANÇ-it meritojnë nderimin e mirënjohjen mbarëkombëtare.

Një grua, një luftë, një ideal: Anastasia Mandro në LANÇ

Anastasia (Cia) Mandro me armë në dorë për lirinë e Atdheut

Cia Mandro ishte fëmija e tretë e familjes dhe ishte lindur, më 12 të Vjeshtës së Parë (shtator) të vitit 1923, në qytetin e Vlorës në lagjen e vjetër dhe të njohur “Muradije” (sot lagja “Hajro Çakërri”). Edhe pse emri i saj ishte “Anastasia” që do të thotë “ringjallje”, por që babai ia vendosi për ringjallje të shqiptarizmës, pasi ajo erdhi në jetë në kohë të vështirë dhe 7 prilli i 1939-ës e gjeti në moshën 16 vjeçare. Ajo nuk pranonte përkëdhelitë prindërore përpara robërimit fashist. Kështu që nuk kishte më fëmijëri për të dhe për dy vëllezërit më të mëdhenj dhe një vëlla më të vogël. Oxhaku “Mandro”, ku erdhi në jetë Cia ishte një vatrë e ngrohtë atdhetarie e patriotizmi, me prindër që gëzonin respekt në mbarë qytetarinë vlonjate, me trashëgimi të spikatur për atdhedashuri dhe përkushtim në breza, bashkë me familjet e tjera me rrënjë vlonjate.

Fëmijëria shkoi në shkollën qytetase, ku ishte e etur për dritë diturie dhe shquhej për rezultate shumë të larta dhe kjo u vërtetua që edhe shkollimi i saj ishte tepër cilësor, por pas lufte dhe sidomos pas shërimit të dy plagëve të marra në luftën antifashiste partizane. Shkollimi i saj u ndërpre për shkak të luftës dhe shkolla e luftës për Cian ishte më shumë se një universitet. Cia Mandro kishte marrë pjesë bashkë me vëllezërit në njësitet guerile të qytetit të Vlorës. Aktiviteti i tyre kulmoi me pjesëmarrjen masive për demonstratën e bukës, më 9 mars 1942. Cia ishte pjesëmarrëse bashkë me vëllezërit e saj në përleshjen me milicët fashistë më 7.8.1942 te sheshi Flamurit, ku vritet anëtari i njësiteve guerile Teli Ndini, duke shpërndarë trakte; por dhe hedhja në erë e depove në Radhimë me dinamit, më 9.8.1942, nga Shyqyri Alimerko, duke e ndezur me fitil e eshkë ishte fryt i punës aktive të njësiteve guerile, ku bënte pjesë edhe Cia Mandro familjarisht. Në kohën kur lufta çlirimtare kishte marrë hov të madh dhe pushtuesi kishte ngrënë grushte të fuqishëm nga formacionet e porsakrijua partizane, edhe në qytet për motër e vëlla për Cian dhe Dhimitrin ishte “mbushur kupa” dhe nuk mund të qëndronin më në ilegalitet. Rruga e lavdishme partizane ishte plotësisht e hapur për ta. Ndër misionet vendimtare në qytetin e Vlorës ishte rrëmbimi i shtypshkronjës dhe dërgimi i saj në një zonë të sigurt, një veprim plotësisht i organizuar dhe koordinuar ku morën pjesë vëlla e motër Dhimitër e Cia Mandro.

Rrëmbimi dhe largimi i saj drejt Ujit të Ftohtë, Jonufrës, Radhimës dhe Tragjasit është i njohur dhe për këtë veprim energjik në mbështetje të luftës çlirimtare e kanë përshkruar mjaft libra e gazeta, që flasin për formacionet partizane të Vlorës që shkruan me gjak triumfin ndaj fashizmit nga Tërbaçi në Sanxhak, një rrugëtim luftarak prej tremijë kilometrash. Nga të dhënat e studiuesve të luftës çlirimtare partizane, ish-ushtarakë e historianë të Vlorës gjejmë fakte interesante se, “në një pronë të Manush Myftiut në fshatin Çepirat ishte transferuar një pjesë e teknikës tipografike dhe funksiononte për LANÇ-in. Nga familja e Manush Myftiut si një nga aktivistët kryesor të luftës që në fillesat e saj, kanë marrë pjesë pesë luftëtarë, Manushi, Lejla, Behixhe, Sulo dhe Mahmuti. Edhe në “Vrenes” ka qenë një bazë e rëndësishme e teknikës te shtëpia e Llaqi Papës. Kontributi i intelektualëve të profesioneve të ndryshëm të punësuar në administratë ka qenë i shquar sikurse ishte Halit Dobi, drejtor i postë-telegrafit Vlorë, që e kishte kthyer shtëpinë në bazë lufte dhe në institucionin ku punonte, në postë kishte punësuar disa luftëtar guerilas si: Hydai Bejo, Thanas Gaba, Arif Hasko, Reiz Malile, Amali Pjerro etj. Por në rreshtat partizane Anastasia (Cia) Mandro gjeti mjaft shoqe të idealit, antifashiste të vendosura sikurse ishte Zonja Çurre dhe shoqe të tjera të saj si: Hanko Muço, Jeta Veshi, Afërdita Thanasi, Inajete Ramadani, Rana Thani, Gjena Shanko, Hyrvete Halimi, Nënço Osman, Rexho Kapo, Donika Çakërri, Naile Ferra, Stoli Xhemali, Kanerina Sulo, Liri Aranitasi, etj. Ishin mbi 50 gra e vajza partizane vlonjate dhe nga gjithë Labëria. (Historiku BrVS, Tiranë, 1989, faqe 129). Në një prej luftimeve të Brigadës trimëresha dhe vajza guximtare e Vlorës mori dy plagë të rënda por me barelë u transportua në Bregdet dhe prej andej me anijet e aleatëve drejt Barit, ku ishte instaluar Shtabi Aleat i Mesdheut që mbështeste luftën tonë. Doktorët e shpëtuan nga kthetrat e vdekjes Cia Mandron, për të jetuar gjatë dhe për të shërbyer denjësisht shtetit të ri shqiptar të pas luftës. Atje në Bari mësoi edhe për vrasjen e shoqes së saj të ngushtë Zonjës, bijës së Arif dhe Salihe Çurre. Më 22 korrik 1944, kur Brigada e saj zhvillonte luftime të ashpra dhe batalioni i katërt luftonte në Qafë Shkallë të Klosit në këto luftime ra Zonja Çurre, një trimëreshë e rrallë, një shoqe dhe mikeshtë e betejave të panumërta partizane. Për luftimet e përgjakshme në Qafë Shkallë të Klosit, ku ra heroikisht Zonja Çurre, lajmi mbërriti edhe në Bari të Italisë dhe për Cian ishte një moment shumë i prekshëm dhe i dhimbshëm, që po i shkëputej një copëz e shpirtit, por e ngushëllonin ditët e lirisë që

po afronin për Atdheun. Anastasia u kthye në Vlorë bashkë me lirinë dhe plotësisht e shëruar, e gatshme për të marrë përgjegjësi për ngritjen e Shqipërisë së re.

Gazeta/buletini partizan “Buçitja” (1944) e Brigadës V Sulmuese

Kur përmendim emrin Cia dhe Dhimitër Mandro si emra mjaft të njohur në Vlorë, menjëherë na vjen ndër mendje teknika e shtypit, shtypshkronja dhe shtypshkrimet, propaganda aq e nevojshme gjatë luftës, brigada heroinë, Br.V Sulmuese dhe Gazeta/Buletini “Buçitja”. Ata ishin në radhët e para të luftës në rreshtat partizane, në Vlorën heroike dhe në brigadën heroike “Hero i Popullit”. Kudo ku kriste gryka e dyfekut gjendeshin edhe Cia me të vëllanë, Dhimitrin. Vëllai i saj ishte njëherazi edhe shok e bashkëluftëtar i një llogoreje me heroin e shquar të luftës Ali Demi (Ali Demi djali nga Filati i Çamërisë që ra hero në Kaninë më 20.12.1943, gjatë një rrethimi nga forca të shumta naziste. Në këtë përleshje u vra dhe partizani Pano Dhimëgjoka dhe plagoset Dhimitër Mandro pranë qafës së Dheut të Bardhë në Kaninë). Ishte koha kur kudo buçiste krisma e fitoreve partizane. Cia me shoqet e saj luftonin krah vëllezërve të një ideali. I kishte thirrur zëri i Atdheut. Krahas luftimeve në fletoren e luftës ose gazetën e luftës artikujt e Cia Mandros dhe stafit të “Buçitja” (organ luftarak i Br.VS ishin zjarr dhe barot. Nuk është e rastit që një ndër filozofët e fillim shekullit të shkuar shkruante: “Më mirë një gazetë e zjarrtë propagande që jua kalon njëmijë bajonetave në frontin e luftës”. Dhe e tillë ishte vërtetë, pasi fliste për fitoret e njëpasnjëshme kundërt fashizmit, për mbi 6000 luftëtare partizane, për ortekun e mbi 70 mijë partizanëve shqiptarë, për bijtë e bijat që binin nga rreshtat partizane në betejat për liri, për heroinat Zonja Çurre (që ishte edhe shoqe e Cia Mandros), Margarita Tutulani, Shejnaze Juka, Qeriba Derri, Liri Gero, Inajete Dumi, Ylbere Bilibashi etj. Gazeta të tjera që dolën në këtë periudhë lufte ishin edhe “Përpara në sulm” (1944-1945) organ politik ushtarak i Br.IS; gazeta “Buçitja” (1944) e Br.VS; gazeta “Ylli çlirimtar” (qershor 1944-1945) i Div.IS; gazeta “Pishtari” (1944), Organ i Br.VIIIS; gazeta “Zëri i luftëtarit” (1944) i Br.IVS, gazeta “Horizonti në ndriçim” (1944) i Br.XII S; gazeta “Përpara” (1944) i Div.VS; “Zëri i të riut” (1944-1945) i Br.XIIS; “Iriqi” (1944), Organ satirik, ushtarak i Br.VIS; “Thumbi” (1944), Organ satirik ushtarak i Br.VIIIS etj. Ishte koha kur kishte një bum botimesh në rreshtat e brigadave e divizioneve partizane, por nuk ngeleshin prapa edhe pushtuesit me publikime, por edhe Aleatët anglo-amerikanë. (Gazeta “Mundimi”, ishte propagandistike dhe informative dhe drejtohej nga major Barbrok dhe që vijoi deri në vjeshtë të 1944-s me 38 numra gazete). Botoheshin dhe gazeta poetike të kohës dhe viti 1944, mbahet si viti më i pasur në botimin e gazetave dhe revistave ushtarake, në historikun e të gjithë shtypit shqiptar të krahasuar me shumë dekada, që ishte edhe viti më i vrullshëm për shqiptarët përgjatë Luftës së Dytë Botërore. Përvoja e botimeve direkt në vijën e luftës ishte sipas modelit të ushtrive të mëdha ndërluftuese, që përveç armëve dhe përleshjeve të gjakosura për jetë a vdekje luftohej me të gjithë format, dhe me publikime direkt në vijën e zjarrit, me parulla paniku për kundërshtarin, me pllakada, karikatura, këngë dhe mënyra të tjera. Gazetat flisnin e shkruanin edhe për italianët që erdhën si pushtues dhe u shndërruan në partizanë, përreth 1500 vetë, patën publikime të tyre dhe sidomos dokumente që i përkasin Komandës dhe SHP-së të UNÇSH-së, si dhe të divizionit “Antonio Gramshi”. Ndërkohë që buçiste, në popull triumfi i formacioneve partizane nuk ndalej edhe gazeta “Buçitja” ku kishte kontribut të shquar padyshim edhe Cia Mandro. Në këtë gazetë pasqyrohej rruga luftarake e Brigadës së Pestë Sulmuese si shembull lufte dhe rezistence për gjithë formacionet e tjera partizane, flitej për rrugën luftarake prej 3700 km pa njohur dështime, por vetëm fitore, flitej e shkruhej për luftën si internacionalistë ku çliruan Kosovën dhe një pjesë të Bosnjës (ish-Jugosllavi), për frymëzimin dhe shpresën që ngjallnin kudo ku kalonin, për të rënë të fushën e betejës për të mos vdekur kurrë, për 357 dëshmorë, për dëshmorin e parë, që ishte edhe komandanti i parë i Brigadës, Heroi i Popullit Abaz Shehu, për trembëdhjetë heronj të Popullit të kësaj brigade, Zonja Çurre, Abaz Shehu, Zaho Koka, Laze Nuro, Llambro Andoni, Nimete Progonati, Dervish Hekali, Kastriot Muço, Hysen Çino, gazeta fliste edhe për të plagosurit në luftë dhe një ndër të plagosurit rëndë ishte edhe vetë Cia Mandro. Atë e shpëtuan nga kthetrat e vdekjes vetëm përkujdesja dhe përkushtimi partizan që e dërguan me urgjencë në Itali, në Bari (Bari është kryeqyteti i Provincës së Barit dhe rajonit të Pulias, në Itali. Ai është qendra e dytë më e rëndësishme ekonomike në Italinë e Jugut pas Napolit). Në Bari funksiononte Shtabi Aleat i Mesdheut, ku mjekët bënë të pamundurën dhe e kthyen në jetë këtë vajzë trimëreshë vlonjate që në deje i vlonte gjaku i lirisë së Atdheut.

Partizane – ky emër i ndritur për vajzat vlonjate dhe gjithë vajzat shqiptare

Rubrikat për ngjarje, data, njerëz në përditshmërinë e shtypit shqiptar edhe në këto tre dekada e gjysmë demokraci kanë qenë të shumta. Për figurën e luftëtares antifashiste Cia Mandro kanë folur bashkëkohësit, veçanërisht nëpër faqet e gazetave të përditshme shqiptare sikurse është edhe gazeta “Intervista”: “Në kujtim të

Cia Mandros”. Po e sjellim sipas origjinalit një shkrim të vlonjatit të mençur Anesti Çaushit publikuar në gazetën “Intervista”, më 6.12.2014 (nr.1083): “Në një shtëpi dykatëshe te familja e Jani Mandros, në lagjen “Muradije”, sot Hajro Cakerri te Sheshi i Flamurit pranë Xhamisë së Kuqe, lindi veterania e luftës Nacionalçlirimtare Aspasi Mandro, apo siç e njih gjithë Vlora, Anastasia (Cia) Mandro. Në moshë shumë të re i vdes e ëma nga një sëmundje e rëndë dhe lë dy fëmijë, Anastasia (Cia) dhe Dhimitër Mandron. Cien dhe vëllanë e saj, lëvizja antifashiste i gjeti në moshë të re, por ata bëhen pjesë e lëvizjes. Gjatë lëvizjes antifashiste, vëlla e motër janë aktivistë dhe inkuadrohen në Brigadën e Pestë Sulmuese. Gjatë luftës, cilësohen për guxim dhe trimëri. Mbas mbarimit të luftës, Cia punon në Komitetin Qendror antifashist në Tiranë. Më vonë mbaron Fakultetin e Drejtësisë dhe punon në shumë qytete. Cia stabilizohet në qytetin e Vlorës, ku punon në kolektivin e avokatëve dhe më vonë, si krye sekretare në Gjykatën e Vlorës ku mbyll dhe karrierën e saj. Cia respektohet nga të gjithë, dallohet për korrektësi dhe saktësi si në punë dhe ishte e dashur dhe e respektuar. Nga martesa e saj, ajo lindi një djalë, Ilir Mandron, i cili vazhdoi studimet e larta dhe sot mban titullin profesor në fushën e ekspertimit të kriminalistikës. Për nder të së ëmës, ai i ka vënë emrin vajzës së tij Cia. Nga një goditje në zemër ndërroi jetë në Tiranë, në shtëpinë e të birit. Familja humbi njeriun më të dashur, të afërmit dhe shoqëria humbën njeriun më të dashur dhe të respektuar. Cia, megjithëse ka kaluar një kohë e gjatë, kujtohet nga familja, nga të afërmit dhe shoqëria, me respekt dhe dashuri sepe e meriton atë”. (Shënojmë këtu se, Anesti Çaushi ka qenë inxhinier nafte dhe ishte djali i tezes së Cia Mandros si dhe vëllai i gruas së Naum Priftit). Kujtimet nga LANÇ-i i gjen në gjithë Vlorën dhe fshatrat e saj. Është sikurse thuhet “pëllëmbë e histori”. Populli bëri që të funksiononte edhe shtypshkronja partizane, pasi Cia Mandro dhe vëllai i saj Dhimitri pasi veprimtaria e tyre u diktua nga fashistët në qytet, më 25 shkurt 1943, një ditë shumë e ftohtë, bashkë me shtypshkronjën shkuan në drejtim të Radhimës në Tragjas dhe prej andej shkuan në Tërbaç, nga rruga e vetme që ishte Qafa e Shëngjergjit, duke kaluar më parë Tragjasin dhe Dukatin. Ata e njihnin mirë faqen e malit te shpella e Rugjinës në Radhimë. Nëpër faqet arkivore gjejmë: “... nga Radhima, rreth orës 4.00-4.30 pasdreke, u nisën 12 mushkat e ngarkuara të mbuluara me ndonjë mushama apo rrobë të leshtë, me grupe dy nga dy dhe tre nga tre. Në fillim nisa Hasan Muharremin me një djalë trupmadh të Shirokës, gati 20 minuta për të vroituar rrugën se mos kishte ndonjë pritë apo gjë

Kur përmendim emrin Cia dhe Dhimitër Mandro si emra mjaft të njohur në Vlorë, menjëherë na vjen ndër mendje teknika e shtypit, shtypshkronja dhe shtypshkrimet, propaganda aq e nevojshme gjatë luftës, brigada heroinë, Br.V Sulmuese dhe Gazeta/Buletini “Buçitja”. Ata ishin në radhët e para të luftës në rreshtat partizane, në Vlorën heroike dhe në brigadën heroike “Hero i Popullit”.

të dyshimtë dhe në fund qëndrova vetë me djalin e mulla Mustafait dhe Qerim Berdon. Të gjithë ishin porositur që për dyshimin më të vogël të mos ndesheshin, por të anashkalonin dhe të na jepnin sinjal nëpërmjet shenjave që do të vendosnin në rrugë (togje gurësh në mes të rrugës ose ndalesa e plotë derisa të vinte grupi tjetër). Në fakt rruga ishte fare e hapur, pa provokime dhe prita që po na qetësonte pa ulur vëmendjen. Ashtu i menduar mu kujtua se në mëngjes, në hyrje të shpellës, kur erdhën partizanë e partizane si dhe 10-12 gra e vajza nga Radhima me 4 mushka transportuan faqes së malit nga Kanina materiale të rënda të shtypshkronjës partizane. Rruga malore që shkon drejt Tragjasit e Dukatit deri në qafë, nga larg duket e bukur dhe lehtësisht e kalueshme, por në fakt është shumë e vështirë, me gërxhe të mprehta dhe të ngushta, me zigzage të shumta dhe të gërryera që formojnë shtigje ku vetëm mushkat mund të kalojnë. Në këto monopate mund të lëvizin vetëm ata që e njohin vendin...”. Në vartësi të situatës shtypshkronjën e lëvizën në pyllin e Dushkut dhe në Kuç, por sërish e kthyen në Tërbaç. Vehbi Hoxha më sqaroi në Vlorë se vendi më i sigurt mbetej Tërbaçi te shtëpia e Nuredin Selmanit. Ajo ishte bazë e LANÇ-it në Hokes, një vend strategjik, pyll i rrethuar nga dy lumenj që bashkoheshin te shtëpia, e cila ishte ndërtuar në rrëzë të dy maleve (Qores dhe Boçkës) ku ka vende sekrete dhe mundësi zhvendosjeje në rast rreziku, aty ku ndodhet dhe shpella e Bilbilejve. Miratimin përfundimtar e dha Hysni Kapo që ishte shumë i kënaqur nga puna për sistemimin e shtypshkronjës. Komiteti Qarkor caktoi përgjegjës administrator Thanas Nanon dhe ekipin me shokët Mihal Shkurti, Muharrem Kasapi Stathi, Nazir Asllani, Sazan Halim Xhelo, Anastasia (Cia) Mandro, Jeta...dhe të tjerë.

Të gjithë të mrekullueshëm dhe të aftë që mbulonin sektorin e radios, lajmeve, propagandën, dokumentacionin dhe arkivin e Partisë. Shkruheshin lajme të brendshme, të jashtme, bëhej rubrika për situatën luftarake dhe sistemohej formati, rregulloheshin sipas grupeve ku do të shkonte gazeta dhe deri në mes të natës përfundonte gjithçka. Nazif Asllani (në sekret të plotë) ngarkonte që në mëngjes mushkën grivër laramane dhe ndante gazetën te korrierët, të cilët e shpërndanin në Zonën I Operative Vlorë-Gjirokastër... Lajme nga fronti rus i Ushtrisë së Kuqe të Stalinit që përparonte dhe çlironte popujt europianë. Me çlirimin e Shqipërisë, më 29 Nëntor 1944, shtypshkronja u transferua në Vlorë, kurse në Hokes të Tërbaçit dhe sot gjenden shkronja plumbi që konsumoheshin nga përdorimi, pjesë të rëndësishme e shtypshkronjës veterane të Labërisë. Brigada e pestë Sulmuese, që ishte edhe brigade e Cia Mandros më 12.6.1945 u përqendrua në Kërçovë dhe më 4.12.1945 u kthye në Atdhe dhe u vendos në kazermat e Krastës në Elbasan. Aty qëndroi deri më mars 1946, ndërsa nga Prilli i vitit 1946 deri më prill 1994 u vendos për gjysmë shekulli në Kordhoc të Gjirokastrës.

Cia Mandro – luftëtare, antifashiste dhe intelektuale e spikatur

Cia Mandro i kishte rrënjët në lagjen e njohur të Muradijes që është një prej lagjeve historike, lagje që njihej si “rruga e kafeneve”, më 1912 si “rruga e lirisë”, ku kaloi Isa Boletini me 400 trima të Kosovës dhe sot quhet “Justin Godard”, për nder të këtij politikani francez mik të shqiptarëve, që mbrojti çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris.

Cia Mandro kishte parë me sytë e saj vajza e gra, bij e bija të Labërisë që kishin derdhur gjakun në moshën me të bukur të jetës, me ëndrrën e lirisë në sy dhe ajo ishte një ndër to por që plumbat vetëm sa e plagosën për ta parë më tej diellin e lirisë dhe për të treguar pas çlirimit trimëritë e vajzave që u shpallën heroina. Bashkëkohësit që e kanë njohur flasin për një vajzë dhe më tej për një grua zonjë, që mbarte urtësinë e trevës popullore vlonjate, përfaqësuese e denjë e intelektualizmit vlonjat, e përkushtuar në çdo detyrë, ose sikurse i thonë në Labëri punëmbaruar, grua plot vlera dhe virtyte të trashëguara të familjes. Cian nuk e frikësuan plumbat dhe predhat e artilerisë armike që mendja e saj ishte tek liria edhe kur e transportuan në Bari të Italisë për shërim. Edhe pse është shkruar e përshkuar pak për familjen e saj gjatë luftës, dëshmitë për shtëpinë e saj si bazë lufte dhe për pjesëmarrje



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Në gjurmët atdhetare të patriotëve

Bejto Isufi ka lindur në Mavrovë të Vlorës, në vitin 1926, në një familje të pasur dhe patriotike. Në jetë ishte atdhetar. Bejto Isufi me veprën dhe jetën e tij futet tek atdhetarët e jashtëzakonshëm që këtë atdhedashuri e mbolli në ushtri, shoqëri dhe familje. Babai i tij, Isuf Rustemi Mavrova (Osmanaj) ka qenë në ngritjen e flamurit në Vlorë, luftëtar në Luftën e Janinës dhe pjesëtar në Luftën e Vlorës. Në vitin 1920, ai si komandant i çetës së Mavrovës ka luftuar me Selam Musanë e Sali Vranishtin. Ai mori dy plagë në luftën e 1920, në kokë dhe në gjoks, por jetoi. Është vlerësuar me “Urdhrin e Skënderbeut” për komandant çete e trimëri, si dhe me medaljen patriotike për atdhetari.

Nga banka e shkollës në radhët partizane

Bejto Isufi, në vitin 1939, në Shkollën Tregtare u lidh me lëvizjen komuniste. Bashkëpunoi ngusht me Hysni Kapon dhe me Kadri Hazbiun. Më vonë vijoi bashkëpunimin me Shefqet Peçin. Kur u ngritën çetat partizane në Lumin e Vlorës, Isuf Rustemi ishte i sëmurë, por Hysni Kapos i la amanet djalin.

Ai i tha: “Po të jap këtë plumb, - duke i sqaruar se, - nëse djali tradhton atdheun, këtë plumb futja në lule të ballit. Nëse është patriot atëherë mbroje dhe mbështete”. Bejto Isufi u radhit partizan në Brigadën V Sulmuese, fillimisht me detyrë përgjegjës rinie në batalion dhe më pas zëvendës komisar batalioni. Në moshën 17 vjeçare u largua nga shkolla Tregtare dhe u inkuadrua në rreshtat partizane dhe luftoi për çlirimin e Shqipërisë dhe të Kosovës deri në Sanxhak.

Bejto Isufi, Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare e quante luftën më heroike të popullit shqiptar që jo vetëm çliruan atdheun e vet, por shkuan deri në tokat e ish-Jugosllavisë. Kur shkuan në Gjakovë partizanët shqiptarë ishin të veshur me rrobat angleze, që u kishin dhuruar aleatët. Kur i panë me ato rroba në Gjakovë, gjakovarët menduan se ishin partizanë rus dhe nuk donin t’i mbështesnin. Nuk i pritën mirë. Bejto Isufi del me flamurin shqiptar në mes të Gjakovës dhe e valëvit në sheshin kryesor. “Ne jemi shqiptarë”, u sqaron duke valëvitur flamurin e lirisë. Shtabi i batalionit nuk donte ta linte të dilte me flamur se ishte i ri, por luftëtari Bejto doli në rrugët e Gjakovës dhe u përqaftua me vëllezërit shqiptarë të Kosovës.

Formimi profesional dhe karriera ushtarake

Bejto Isufi pas çlirimit të vendit kreu shkolla dhe Akademinë Ushtarake “Xherxhinski” të Moskës. Ai punoi oficer i lartë në radhët e Ushtrisë Kombëtare dhe më pas në atë Popullore, si kuadër politik e ushtarak, komisar regjimenti në Forcat e Mbrojtjes së Popullit dhe më pas, mbasi mbaroi Akademinë Ushtarake në BS dhe në Shqipëri, mori detyra të larta, si komandant i MKA të shtetit, komandant i Grupimit VI Operativ të Tiranës etj., detyra të cilat i kreu me sukses e devotshmëri. Nga udhëheqja e lartë e asaj kohe, u ngarkua me një detyrë shumë të rëndësishme siç ishte ajo e komandantit të Paradës Ushtarake me rastin e 30-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë. Për merita në luftë dhe në punë është dekoruar me urdhra e medalje nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Ka mbajtur gradën e Kolonelit deri në vitin 1966, kur u hoqën gradat ushtarake.

Qëndresa profesionale dhe përplasja me dogmën

Ushtaraku Bejto Isufi u përplas me drejtuesit e stërvitjes ushtarake me trupa në fund janari të vitit 1979, ku stërvitja fillonte në Tiranë dhe përfundonte në Bizë të Martaneshit. Ishte një stërvitje ushtarake me trupa në gjurmë të Brigadës I Sulmuese.

BEJTO ISUFI,

komandant qëndrestar në Ushtri



Këtë stërvitje e kishte ideuar Mehmet Shehu, kryeministër dhe ministër i Mbrojtjes, ku Brigada e Parë Këmbësore duhej të zhvillonte një stërvitje të kompletuar me të gjithë efektivin e saj aktiv dhe rezervistë, si në luftë të vërtetë. Shtabit të njësisë dhe Grupimit të Tiranës nuk iu dhanë më tepër udhëzime për stërvitjen.

Brigada e Parë e Këmbësorisë ishte vazhduese e Brigadës I Sulmuese, e krijuar më 15 gusht 1943, në Vithkuq të Korçës. Efektiv i kësaj njësie jetonte me imazhin e lavdishëm, kuadrot që shërbenin në këtë njësi ecnin më shpejt në karrierën ushtarake. Ishte një ndër brigadat më të kompletuara të ushtrisë, tek e cila zhvilloheshin mjaft stërvitje treguese dhe eksperimentale në shkallë ushtrie. Detyra e parë kryesore e brigadës, ishte mbrojtja e kryeqytetit, kryesisht nga desanti ajror dhe detyra e dytë e saj, si rezervë e Komandës së Përgjithshme, të ishte e gatshme të vepronte në ndihmë të njërive operative, që vepronin në drejtim të bregdetit, apo në kufirin verilindor. Në fund të viteve ‘70 Ushtria

Popullore shqiptare ishte e përbërë nga 9 korpuse dhe 2 grupime: ai i Tiranës dhe Elbasanit. Për nga rëndësia, Grupimi i Tiranës ishte i pari, për më tepër kur në përbërje të tij ishin mbi 20 njësi të fuqishme të ushtrisë shqiptare, të cilat ishin të vendosura jo vetëm në Tiranë, por shtriheshin dhe në Laç, në Mirditë dhe në Vaun e Dejës. “Veçanërisht, nga viti 1975-1978, pas asgjësimit të grupit “puçist” në ushtri, Mehmet Shehu, në atë kohë kryeministër dhe ministër i Mbrojtjes, ndoqi nga afër stërvitjet treguese.

Urdhri për të zhvilluar një stërvitje të madhe ushtarake, nuk dha rezultatet e pritura. Stërvitja në ato ditë të ftohta janari, kulmoi në Bizë të Martaneshit. Bejto Isufi, në atë kohë ishte komandanti i Grupimit VI Operativ të Tiranës. Gjatë stërvitjes me trupa pati dhe ngjarje të jashtëzakonshme. Duke njohur situatën, Bejto kundërshtoi si periudhën e stërvitjes, ashtu edhe përfshirjen e gjerë të rezervistëve që, sipas tij, nuk ishin të përgatitur për t’u përballur me kushtet e ashpra të dimrit. Ai propozoi që pjesa më e madhe të



ishin ushtarë aktivë, të stërvitur çdo ditë për situata të tilla. Nëse do të përfshiheshin rezervistë, të zgjidheshin ata që jetonin në zona me klimë të ashpër, të mësuar me terrene të vështira.

Këto mendime u kritikuan duke i thënë se “po mbështet tezat e Beqir Ballukut”. Ai u përgjigj qartë se kishte qenë ndër të parët që i kishte hedhur poshtë ato teza, por se kjo ishte çështje konkrete që duhej gjykuar sipas realitetit të terrenit. Pavarësisht argumenteve të tij, u vendos që stërvitja të zhvillohej siç ishte planifikuar. Bejto i qëndroi pranë gjithë procesit, nga fillimi në fund, duke mbikëqyrur çdo problem dhe çdo hallkë të saj.

Kur panorama u bë edhe më e vështirë, dhe duke parë se stërvitja e kishte përmbushur objektivin, Bejto propozoi që kthimi të bëhej me tren nga Librazhdi. Një nga problemet e stërvitjes ishte se trupat nuk veshën rrobat dimërore. Nga kjo stërvitje me trupa nuk po gjendej arsyeja kryesore e dështimit të saj. Bejto Isufi e quajtën trockist, se përkrahte mendimin se rezervistët nga fshati duhet të jenë në frontin e parë, pra kryesor. Nga kjo stërvitje mori masë në parti duke e bërë kandidat partie, por nga detyra ushtarake nuk e lëvizën.

Libri i ndaluar dhe përvoja vietnameze

Bejto Isufi vendosi që gjithë kulturën, eksperiencën dhe njohuritë e fituara gjatë një karriere të gjatë ushtarake t’i sistemonte në një libër. Karriera e tij ushtarake fillonte që në luftë, por intensive ajo u bë në vitet 1950, me studimet në Akademinë Ushtarake “Xherxhinski” në BS, specializimin si komando inxhinier, si dhe formimet e shumta në fushën e raketave në vitet ’60 e më vonë. Përveç këtyre, ai mbante mbi supe përgjegjësi të rëndësishme si komandant i MKA-së. Të gjitha këto përvoja kulmuan me një periudhë veçanërisht të rëndësishme: misionin tre mujor në Vietnam. Duke pasur parasysh rrethanat e ndërlikuara ndërkombëtare të kohës, sidomos tensionet në Europë e në Ballkan, Ministria e Mbrojtjes e konsideroi të domosdoshme dërgimin e një delegacioni ushtarak shqiptar për të parë nga afër zhvillimet e luftës vietnameze. Delegacioni përbëhej nga: Bejto Isufi, komandant i MKA-së, Fahri Bubsî, ndër pilotët më me përvojë të aviacionit shqiptar, Vaskë Gjino, kuadër me përvojë në fushën ushtarake.

Pasi u kthye, Bejto Isufi punoi me pasion dhe përkushtim për

të dokumentuar gjithë këtë përvojë ushtarake. Përgatiti një libër me rreth 200 faqe, të shoqëruar me skema, tabela, fotografi dhe analiza të hollësishme të taktikave luftarake, sidomos të luftës ajrore amerikane. Libri nuk ishte thjesht një përshkrim, por një manual studimor që mund të pasuronte trajnimet e kuadrove të rinj. Por pak kohë pas botimit, libri u tërhoq nga qarkullimi pa dhënë asnjë shpjegim. Të gjitha kopjet e shpërndara për efekt studimi u

në një mbledhje partie të jashtëzakonshme. I pa informuar për temën dhe pa asnjë paralajmërim, Bejto u përball me faktin se mbledhja ishte organizuar posaçërisht për të diskutuar një ngjarje të ndodhur disa ditë më parë: udhëtimin e tij të papritur me Kadri Hazbiun drejt Mavrovës.

Në mbledhje u hodhën mbi 250 pyetje, shumica të përgatitura, të dobëta në përmbajtje dhe pa argumentim, të lexuara mekanikisht

Bejto Isufi pas çlirimit të vendit kreu shkolla dhe Akademinë Ushtarake “Xherxhinski” të Moskës. Ai punoi oficer i lartë në radhët e Ushtrisë Kombëtare dhe më pas në atë Popullore, si kuadër politik e ushtarak, komisar regjimenti në Forcat e Mbrojtjes së Popullit dhe më pas, mbasi mbaroi Akademinë Ushtarake në BS dhe në Shqipëri, mori detyra të larta

urdhëruan të ktheheshin. Më tej, Bejtos iu kërkua të dorëzonte edhe të gjitha materialet ndihmëse që kishte përdorur për hartimin e tij.

“Përgjigjem vetëm për sjelljen dhe moralin tim”

Vitet më pas, para daljes në pension në vitin 1982, si komandant i Garnizonit dhe Grupimit të Tiranës, Bejto Isufi, i pajisur me një përvojë të gjatë ushtarake e drejtuese, shprehu gatishmërinë për të ofruar mbështetje profesionale në Akademinë Ushtarake. Këto konsulenca, të ofruara pa asnjë pagesë dhe pa asnjë interes personal, u mirëpritën dhe u vlerësuan nga drejtuesit e institucionit. Për Bejton, kjo periudhë qe një kënaqësi e veçantë morale: ndjehej i dobishëm, i respektuar dhe i vlerësuar për kompetencën dhe karakterin e tij. Në kulmin e këtij angazhimi, ai u thirr nga sekretari i partisë së Akademisë për të marrë pjesë

nga anëtarë partie të rekomanduar. Procedura nuk i la hapësirë për t’u përgjigjur qetësisht apo për të shpjeguar qëndrimin e tij. Kjo mënyrë e zhvillimit të mbledhjes krijoi konfuzion edhe te vetë anëtarët e partisë, që nuk e miratonin këtë metodë. Në një moment të caktuar, pyetja shkon deri në absurditet: “Çfarë mendon për moralin e vajzave të Kadri Hazbiut? Përgjigjja e Bejtos, e prerë, e ndershme dhe dinjitoze, mbeti në kujtesën e të gjithëve: “Unë sot nuk përgjigjem dot as për moralin e vajzave të mia. Unë mund të përgjigjem vetëm për sjelljen dhe moralin tim”. Kjo fjali përmbledh karakterin e tij të pathyeshëm. Bejto Isufi ishte bashkautor i “Historikut të Brigadës V Sulmuese”, anëtar i Redaksisë Operative të Fjalorit Enciklopedik Ushtarak Shqiptar, si dhe autor i shumë shkrimeve në shtypin ushtarak. U nda nga jeta në vitin 1995, në Tiranë, duke lënë pas një trashëgimi të vyer profesionale, morale dhe kombëtare.

Flotilja ushtarake në rrugëtimin e saj 61-vjeçar mbi ujërat shqiptare

Baza Detare e Durrësit, histori sakrifice, profesionalizmi dhe suksesi

Nga riorganizimi strategjik të lindja e një baze jetike

Historia e Forcave Detare Shqiptare është e lidhur ngushtë me zhvillimet politike, ushtarake dhe strategjike të shtetit shqiptar. Një vend të veçantë në këtë histori zë Baza Detare e Durrësit, e cila, më 5 janar 1965, u rikrijua zyrtarisht, duke shënuar një etapë të re në mbrojtjen e ujërave territoriale të vendit.

Në fund të vitit 1964, Këshilli i Mbrojtjes i asaj kohe mori vendimin për ristrukturimin e Flotës Luftarake Detare (FLD), e cila deri atëherë funksiononte e centralizuar me vendbazim në Ishullin e Sazanit. Ky riorganizim erdhi si domosdoshmëri për rritjen e efektivitetit operacional dhe përballimin e sfidave të reja në hapësirën detare shqiptare.

Vendimi parashikonte ndarjen e anijeve mbiujëse luftarake dhe krijimin e dy flotiljeve kryesore: **Flotilja e Durrësit** dhe **Flotilja e Vlorës**. Si kriter bazë për caktimin e kuadrove u mor vendbanimi, kryesisht qyteti i Durrësit, për të lehtësuar strehimin dhe konsolidimin e efektivave.

Në përbërje të Flotiljes së Durrësit u përfshinë:

- anije minaheqëse,
- gjuajtëse kundër nëndetëseve,
- anije ndihmëse.


Komandant i Flotiljes u emërua Kapiten i Rangut III Dashamir Ohri, një nga figurat më të shquara të Forcave Detare Shqiptare. Ai vinte me një përvojë të pasur profesionale, si ish-komandant i Bazës së Nëndetëseve në Pashaliman dhe si komandant i nëndetësës së parë shqiptare, të ardhur nga Bashkimi Sovjetik. Dashamir Ohri ishte gjithashtu një nga 17 oficerët e parë shqiptarë të diplomuar jashtë vendit që në vitin 1947.

Lundrimi historik Sazan-Durrës dhe ndërtimi nga e para

Më 4 janar 1965, në mesditë, komandanti i sapoemëruar i Flotiljes së Durrësit, **Kapiten Rang III Dashamir Ohri**, organizoi një takim me shtabin dhe komandantët e anijeve, ku u prezantua plani i lundrimit nga Ishulli i Sazanit drejt Durrësit.

Rreth orës 20:00, në një atmosferë solemne, anijet nisën daljen nga Sazani. Lundrimi u krye natën, në formacion të rregullt luftarak dhe në kushte të një deti të trazuar. Sirenat e anijeve shoqëruan nisjen, si një përshëndetje tradicionale dhe simbolike e Flotës Luftarake Detare.

Në mëngjesin e 5 janarit 1965, anijet mbërritën në Radin e Durrësit dhe u akostuan në Kalatën Lindore të Portit Detar. Kjo datë shënon **rikrijimin zyrtar të Bazës Detare të Durrësit**, një ngjarje me rëndësi të veçantë



për historinë ushtarake shqiptare. Por sfidat sapo kishin filluar. Baza pothuajse nuk kishte infrastrukturë. Mungonin bankinat, godinat e komandës, depot, ofiçinat e riparimit, ambientet e përgatitjes speciale dhe kushtet bazë të jetesës për efektivat. Falë përkushtimit të kuadrove dhe punës vetëmohuese të detarëve, si dhe ndihmës së ndërmarrjeve të qytetit të Durrësit, si Porti Detar dhe ndërmarrjet ndihmëse, u arrit ndërtimi i:

- bankinës së silurhedhëseve,
- ofiçinës së silurëve,
- ambienteve teknike për mirëmbajtjen e anijeve.

Këto punime ishin jetike, sidomos në pritje të anijeve të reja që pritej të vinin në vitin 1965 nga Republika Popullore e Kinës.

Zgjerimi, stërvitjet dhe konsolidimi i forcave detare

Në vitet që pasuan, Baza Detare e Durrësit u shndërrua në një qendër të rëndësishme operative. Flotës iu shtuan anije silurhedhëse, gjuajtës detarë, u ndërtuan vendbazime të reja në Porto-Pallë, u zgjeruan ofiçinat e riparimit dhe u ndërtuan godina të reja të komandës dhe shkollës së përgatitjes së efektivave.

Zgjerimi i forcave detare kërkonte edhe rritjen e numrit të kuadrove. Për këtë arsye, shumë oficerë u transferuan nga repartet e artilerisë kundërajrore dhe bregdetare, ndërsa pranë shkollës së specialiteteve u ngritën kurse të posaçme 9-mujore për titullimin e oficerëve të rinj. Në vitet '50-'60, Forcat Detare Shqiptare arritën një nivel të konsiderueshëm modernizimi. Në vitin 1958 përfundoi ndërtimi i Bazës së Pashalimanit dhe rikonstruksioni i Bazës së Sazanit. Për të prezantuar këto arritje, në Gjirin e Vlorës u zhvillua një paradë detare me rastin e përvjetorit të Ushtrisë Popullore.

Një moment kulmor ishte stërvitja e koduar **“Drini-61”**, zhvilluar në shkurt të vitit 1961, ku morën pjesë nëndetëset shqiptare dhe sovjetike, anije mbiujëse, artileria bregdetare, këmbësoria dhe aviacioni ushtarak. Stërvitja u zhvillua në kushte të vështira meteorologjike, por u realizua me sukses të plotë.

Nga tranzicioni politik të NATO, një histori që vazhdon

Pas ndryshimeve politike të vitit 1990, Baza Detare e Durrësit pësoi transformime të rëndësishme në konceptin e detyrave, organizim dhe strukturë. Hapja e vendit solli rritjen e ndjeshme të lëvizjes së anijeve të huaja në ujërat shqiptare, duke shtuar rrezikun e:

- shkeljeve të ujërave territoriale,
- peshkimit të paligjshëm,
- trafikut të drogës, armëve dhe klandestinëve.

Baza Detare e Durrësit u përball me sukses këto sfida, duke u shndërruar në një faktor kyç të sigurisë detare kombëtare. Bashkëpunimi me flotat e NATO-s dhe stërvitjet e përbashkëta rritën ndjeshëm nivelin profesional të kuadrove shqiptare.

Sot, anijet e vjetra që shërbyen në vitet e para të rikrijimit të bazës kanë dalë jashtë përdorimit dhe janë zëvendësuar me anije moderne të ardhura nga SHBA, Italia, Holanda dhe vende të tjera aleate, të pajisura me teknologji bashkëkohore dhe sisteme moderne vëzhgimi detar.

Në këtë 61-vjetor të rrugëtimit të saj, **Baza Detare e Durrësit** përfaqëson një histori suksesi, një trashëgimi të çmuar dhe një garanci për mbrojtjen e sovranitetit detar të Republikës së Shqipërisë.



STACIONI HAPËSINOR RROTULLUES, një revolucion shkencor në krijimin e gravitetit artificial

Prej shumë dekadash, ideja e një stacioni hapësinor që rrotullohet për të krijuar gravitet artificial ka qenë pjesë e imagjinatës së shkrimtarëve të fantashkencës dhe vizionarëve të eksplorimit hapësinor. Në romanet klasike, njerëzit jetonin në struktura gjigante cilindrike që rrotulloheshin ngadalë, duke imituar gravitetin e Tokës. Sot, kjo ide nuk është më thjesht një fantazi letrare, por po merr formë konkrete në laboratorë dhe qendra kërkimore. Projekti i një stacioni të tillë përfaqëson një hap të madh drejt zgjidhjes së një prej sfidave më të mëdha të jetës në orbitë: mungesa e gravitetit.

Pse na duhet gravitet artificial?

Astronautët që jetojnë për periudha të gjata në hapësirë përballen me pasoja serioze shëndetësore. Mikrograviteti, pra mungesa e forcës që i mban trupat tanë të lidhur me tokën, shkakton ndryshime të mëdha fiziologjike. Muskujt fillojnë të atrofizohen, kockat humbasin densitetin, sistemi kardiovaskular pëson ndryshime të rrezikshme, ndërsa shikimi dhe ekuilibri preken ndjeshëm. Këto efekte e bëjnë të vështirë qëndrimin afatgjatë në hapësirë dhe kufizojnë ambicien për misione të gjata drejt Hënës, Marsit apo më tej. Graviteti artificial, i krijuar përmes rrotullimit, mund të ofrojë një mjedis më të përshtatshëm për trupin e njeriut, duke reduktuar rreziqet shëndetësore dhe duke hapur rrugën për eksplorime më të guximshme.

Si funksionon graviteti artificial?


Parimi është i thjeshtë në teori, por sfidues në praktikë. Kur një strukturë rrotullohet, forca centrifugale shtyn objektet drejt jashtë. Në një stacion hapësinor rrotullues, kjo forcë do të imitojë gravitetin tokësor. Shpejtësia e rrotullimit duhet të jetë e mjaftueshme për të krijuar një ndjesi graviteti, por jo aq e lartë sa të shkaktojë marramendje. Diametri i stacionit është gjithashtu kritik: sa më i madh diametri, aq më i butë do të jetë efekti i rrotullimit dhe aq më i natyrshëm do të ndihet graviteti. Një sfidë e madhe është efekti Coriolis, i cili mund të ndikojë në perceptimin e lëvizjes nga astronautët, duke shkaktuar probleme me ekuilibrin dhe koordinimin e tyre.

Sfida teknike të projektit

Ndërtimi i një stacioni hapësinor rrotullues kërkon teknologji të avancuar dhe një planifikim të kujdesshëm. Struktura duhet të jetë e balancuar në mënyrë perfekte për të shmangur deformimet që mund të çojnë në katastrofa. Materialet e përdorura duhet të jenë njëkohësisht të lehta dhe jashtëzakonisht të forta, për të përballuar tensionet e rrotullimit. Energjia e nevojshme për të nisur dhe mbajtur rrotullimin në mënyrë të qëndrueshme është një tjetër sfidë, që kërkon sisteme të avancuara të kontrollit dhe stabilitetit. Përveç kësaj, duhet të kryhen testime të gjera për të kuptuar se si trupi i njeriut reagon ndaj një graviteti artificial të pjesshëm ose të plotë, pasi nuk është e sigurt nëse efektet do të jenë identike me ato të gravitetit natyror të Tokës.

Një laborator i ri për shkencën

Një stacion hapësinor rrotullues nuk do të shërbejë vetëm për të mbrojtur shëndetin e astronautëve. Ai mund të bëhet një laborator unik për studimin e efekteve të gravitetit artificial mbi biologjinë njerëzore. Eksperimente mbi bimët dhe kafshët mund të ndihmojnë në kuptimin e mënyrës se si mund të krijohen ekosisteme të qëndrueshme në hapësirë. Për më tepër, ky stacion do të ofrojë mundësi për testimin e teknologjive që do të përdoren në kolonitë e ardhshme hapësinore, duke e bërë atë një hap të domosdoshëm drejt jetesës përtej Tokës.



Një hap drejt kolonizimit të hapësirës

Nëse koncepti i gravitetit artificial realizohet me sukses, ai mund të shënojë fillimin e një epoke të re. Stacionet rrotulluese mund të shërbejnë si baza tranzitore për misione drejt Marsit, ose si vendbanime të përhershme në orbitë. Kjo teknologji do të lejojë njerëzit të jetojnë dhe të punojnë në hapësirë pa pasojat e rënda të mungesës së gravitetit, duke e bërë më të mundur kolonizimin e hapësirës. Për herë të parë, njeriu do të ketë mundësinë të krijojë kushte të ngjashme me Tokën në një mjedis krejtësisht të huaj.

E ardhmja: Sfida dhe mundësi

Megjithëse projekti është ende në fazë konceptuale, ai përfaqëson një vizion të guximshëm. Sfida teknike dhe ekonomike janë të mëdha, por përfitimet shkencore dhe praktike janë të jashtëzakonshme. Nëse realizohet, stacioni hapësinor rrotullues me gravitet artificial do të vendosë një precedent të ri në historinë e eksplorimit hapësinor, duke e afuar njeriun më shumë se kurrë me ëndrrën e jetesës përtej Tokës. Ky projekt mund të shndërrohet në themelin e kolonive të ardhshme hapësinore, duke hapur një kapitull të ri në marrëdhënien e njerëzimit me universin.



Edukimi ekologjik, nga zakonet e vogla te ndryshimet e mëdha

Kriza klimatike si sfidë globale

Ndryshimet klimatike nuk janë më një parashikim i largët, por një realitet i prekshëm. Përmbytjet, zjarret, thatësiat dhe ndotja e ajrit, janë fenomene që tashmë i përjetojmë çdo vit. Shqipëria, si pjesë e rajonit të Ballkanit, është veçanërisht e ekspozuar ndaj këtyre rreziqeve për shkak të gjeografisë, infrastrukturës së brishtë dhe mungesës së kulturës ekologjike. Në këtë kontekst, edukimi ekologjik bëhet një mjet i pazëvendësueshëm për të përgatitur qytetarët që të kuptojnë, të parandalojnë dhe të reagojnë ndaj krizave mjedisore. Pa një ndërgjegjësim të gjerë shoqëror, çdo politikë apo investim mbetet i mangët.

Edukimi si kulturë e gjelbër

Edukimi ekologjik nuk është thjesht një lëndë mësimore, por një kulturë e gjelbër që duhet të përshkojë çdo aspekt të jetës sonë. Ai nis në shkollë, ku fëmijët mësojnë se si të kujdesen për natyrën, por vazhdon në familje, ku zakonet e përditshme formojnë sjelljen e brezave të rinj. Riciklimi i mbetjeve, kursimi i energjisë, përdorimi i transportit publik, mbrojtja e hapësirave të gjelbra – janë veprime të vogla që, kur bëhen pjesë e kulturës qytetare, sjellin ndryshime të mëdha. Edukimi ekologjik është një proces i vazhdueshëm, që nuk mbaron kurrë, sepse natyra dhe sfidat e saj janë gjithmonë në ndryshim.

Roli i shkollës dhe familjes

Shkolla është hapësira e parë ku fëmijët mësojnë të kuptojnë lidhjen mes njeriut dhe natyrës. Edukimi ekologjik duhet të jetë i integruar në programet mësimore, jo si një lëndë e veçantë që trajtohet sporadikisht, por si një filozofi e përgjithshme e të nxënit. Kur fëmijët mësojnë për riciklimin, kursimin e energjisë, kujdesin për ujin dhe respektin për hapësirat e gjelbra, ata nuk po mësojnë vetëm rregulla, por po formojnë zakone që do t'i shoqërojnë gjatë gjithë jetës. Familja, nga ana tjetër, është laborator i zakoneve të përditshme. Nëse prindërit japin shembullin e duhur duke përdorur qese të ripërdorshme, duke ndarë mbetjet për riciklim, duke kursyer energjinë elektrike dhe duke u kujdesur për hapësirat e përbashkëta, fëmijët do ta marrin këtë sjellje si model. Edukimi ekologjik nuk është vetëm teori, por praktikë e përditshme që nis nga gjërat e vogla dhe ndërtohet mbi shembuj konkretë.

Shoqëria dhe komuniteti

Edukimi ekologjik nuk mbaron në klasë apo në shtëpi. Ai duhet të shtrihet në komunitet, përmes fushatave ndërgjegjësuere, aktiviteteve vullnetare dhe projekteve lokale. Kur qytetarët bashkëpunojnë për pastrimin e një parku, mbjelljen e pemëve apo menaxhimin e mbetjeve, ata jo vetëm që përmirësojnë mjedisin, por edhe forcojnë lidhjet shoqërore dhe ndjenjën e përkatësisë. Një qytet i pastër dhe i gjelbër nuk është vetëm rezultat i punës së institucioneve, por i angazhimit të përbashkët të banorëve.

Media e shkruar ka një rol të rëndësishëm në këtë proces, sepse përmes artikujve, reportazheve dhe analizave mund të nxisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të promovojë shembuj pozitivë. Kur lexuesit shohin se komunitete të tjera kanë arritur rezultate konkrete në mbrojtjen e mjedisit, ata frymëzohen për të vepruar në zonën e tyre. Edukimi ekologjik është një proces kolektiv, ku çdo individ ka një rol dhe çdo veprim ka një ndikim.

Teknologjia si aleat i gjelbër

Në epokën digjitale, edukimi ekologjik mund të përfitojë shumë nga teknologjia. Aplikacionet që monitorojnë konsumin e energjisë, platformat online për riciklimin, laboratorët e gjelbër të universiteteve dhe projektet e inovacionit të qëndrueshëm janë shembuj se si teknologjia mund të shërbejë për ndërgjegjësim dhe veprim konkret. Përmes teknologjisë, qytetarët mund të mësojnë më shpejt, të ndajnë përvoja dhe të gjejnë zgjidhje kreative për problemet mjedisore. Inovacioni nuk është vetëm një mjet për zhvillim ekonomik, por edhe një instrument për mbrojtjen e natyrës. Kur të rinjtë angazhohen në projekte teknologjike që lidhen me energjinë e pastër, menaxhimin e mbetjeve apo mbrojtjen e biodiversitetit, ata jo vetëm që mësojnë aftësi të reja, por edhe kontribuojnë në ndërtimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme. Edukimi ekologjik duhet të shfrytëzojë potencialin e teknologjisë për të bërë ndryshimin më të prekshëm dhe më të arritshëm për të gjithë.



● Shkolla është hapësira e parë ku fëmijët mësojnë të kuptojnë lidhjen mes njeriut dhe natyrës. Edukimi ekologjik duhet të jetë i integruar në programet mësimore, jo si një lëndë e veçantë që trajtohet sporadikisht, por si një filozofi e përgjithshme e të nxënit.

Shembuj ndërkombëtarë

Vendet e zhvilluara kanë kuptuar prej kohësh rëndësinë e edukimit ekologjik. Në Finlandë, fëmijët mësojnë që në klasat e para se si të menaxhojnë mbetjet dhe të kursejnë energjinë. Në Gjermani, riciklimi është pjesë e kulturës kombëtare, ndërsa në Japoni, respekti për natyrën është i integruar në traditën dhe edukimin e çdo qytetari. Shqipëria mund të mësojë nga këto modele, duke i përshtatur sipas realitetit të saj. Për shembull, një program kombëtar për riciklimin e mbetjeve në shkolla do të krijonte një brez të ri që e sheh riciklimin si pjesë të natyrshme të jetës.

Edukimi ekologjik dhe ekonomia

Një aspekt shpesh i nënvlerësuar është lidhja mes edukimit ekologjik dhe ekonomisë. Një shoqëri e ndërgjegjësuare për mjedisin prodhon më pak mbetje, kursen më shumë energji dhe investon në teknologji të pastra. Kjo jo vetëm që ul kostot ekonomike, por krijon edhe vende të reja pune në sektorë si energjia e rinovueshme, menaxhimi i mbetjeve dhe turizmi i qëndrueshëm. Edukimi ekologjik nuk është vetëm një çështje morale, por edhe një strategji zhvillimi ekonomik.

Edukimi ekologjik është një investim afatgjatë, që formon

qytetarë të përgjegjshëm, të aftë të marrin vendime të mençura për mjedisin dhe të ardhmen e tyre. Ai nuk është një proces që sjell rezultate të menjëhershme, por një rrugëtim që kërkon durim, përkushtim dhe bashkëpunim. Nëse duam një Shqipëri më të gjelbër, më të shëndetshme dhe më të qëndrueshme, duhet ta vendosim edukimin ekologjik në zemër të politikave arsimore, kulturore dhe shoqërore.

Media e shkruar ka një rol të pazëvendësueshëm në këtë mision, sepse përmes fjalës së saj mund të frymëzojë, të informojë dhe të mobilizojë qytetarët. Edukimi ekologjik nuk është vetëm një çështje e mjedisit, por një çështje e demokracisë, e kulturës dhe e identitetit tonë kombëtar. Ai është garancia që brezat e ardhshëm do të jetojnë në një vend ku natyra respektohet, ku zhvillimi është i qëndrueshëm dhe ku njeriu është në harmoni me mjedisin.

Në fund të fundit, edukimi ekologjik është një thirrje për përgjegjësi kolektive. Çdo veprim i vogël – nga riciklimi i një shisheje plastike, te mbjellja e një peme apo kursimi i energjisë – është një hap drejt një të ardhmeje më të mirë. Nëse sot e vendosim edukimin ekologjik si prioritet, nesër do të kemi një shoqëri më të ndërgjegjshme, një ekonomi më të qëndrueshme dhe një mjedis më të pastër për fëmijët tanë.



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Dy 80-vjetorë, një histori e përbashkët

Sapo u festua 80-vjetori i Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” dhe Viti i Ri 2026 sjell një tjetër jubile madhor: 80-vjetorin e Klubit Sportiv “Partizani”. Një përkim domethënës, sepse historia e këtyre dy institucioneve ecën paralelisht, e lidhur ngushtë nga ideali, disiplina, përgatitja fizike dhe fryma e garës.

Shkolla “Skënderbej”, baza e formimit sportiv

Sidomos pas mes-viteve ’50, ndërsa Shkolla “Skënderbej” rritej dhe modernizohej, drejtuesit e KS “Partizani” i kushtonin vëmendje të veçantë nxënësve të saj, duke përzgjedhur djelmoshat me fizik të zhvilluar, karakter të fortë dhe disiplinë shembullore. Por ky proces nuk ishte rastësor. Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Popullore e shihnin sportin si komponent thelbësor të përgatitjes së kuadrove ushtarake.

Një rol të veçantë në këtë filozofi luajti Gjenerallejtënant Petrit Dume, i njohur edhe si “tifozi nr. 1 i “Partizanit”, i cili mbështeti fuqimisht përgatitjen dhe afirmimin e sportistëve cilësorë në të gjitha disiplinat.

Brezat e viteve ’70 – koha e talenteve

Autori i këtyre radhëve i përket brezave të fillim-viteve ’70, një periudhë kur në Shkollën “Skënderbej” studionin dhe stërviteshin sportistë që më pas do të bëheshin emra të mëdhenj të KS “Partizani” dhe të sportit shqiptar: Agim Murati dhe Perlat Musta në futboll; Kastriot Mushi dhe Avenir Kalaja në basketboll; Abedin Lame, vëllezërit Ndue dhe Skënder Doda në mundje; Besnik Satka në atletikë, e shumë të tjerë.

Sherif Çiçiku dhe shkolla e suksesit

Ishte pikërisht kjo periudhë kur filloi të spikaste edhe figura e trajnerit Sherif Çiçiku, i cili krijoi një ekip aq të fortë, saqë në ndeshjet stërvitore edhe ekipet e para të “Dinamos” apo “Partizanit” ishin të kënaqura me një barazim. Mjeshtri Loro Boriçi dhe pasuesit e tij shpesh ndodheshin përballë dilemës së vështirë të përzgjedhjes.

Rasti i Perlat Mustës është ilustrues: një talent i jashtëzakonshëm që e nisi karrierën me “Partizanin” drejtpërdrejt në një ndeshje ndërkombëtare dhe që më pas u shndërrua në një nga portierët legjendarë të futbollit shqiptar.

Emra që i dhanë lavdi fanellës së kuqe

Lista e skënderbegasve që kanë veshur fanellën e “Partizanit” është e gjatë dhe përfshin emra si: Arjan Ahmetaj, Artur Lekbello, Agim Bedini, Astrit Xhakolli, Luftar Guri, Azis Çeço, e dhjetëra të tjerë që lanë gjurmë në fushat e lojës dhe në historinë e klubit.

Plejada e kampionëve dhe edukatorëve

Krahas tyre, përmenden me respekt Neptun Bajko, Suvorov Nikolla, Bashkim Lika, Kristaq Laçi, Mikel Janku, Faruk Kalleshi, Torez Çiraku, vëllezërit Perlat e Ilirian Çako, Telemak Thanasko, Elez Gjoza, Besnik Kurshumi, Perlat Sula, Luke Shaqiri, Ruzhdi Kola, Bashkim Topçiu, Bashkim Myhedini – emra që kanë qenë shembull i shpirtit të garës dhe sakrificës.



Partizani, Historia e një legjende të futbollit shqiptar

Brezat Skënderbegas - Fidanishte edhe për KS “Partizani”



Mësuesit–trajnerë, shtylla e formimit

Një vend nderi në këtë histori zënë mësuesit e Shkollës “Skënderbej”, të cilët njëkohësisht ishin edhe trajnerë të “Partizanit”. Sa e sa skënderbegas krenohen që janë formuar nga mjeshtra si Astrit Greva, Njazi Lleshi, Kolec Kraja, Xhavit Xhani, Dashamir Fagu e shumë të tjerë.

Një trashëgimi që meriton vlerësim institucional

80-vjetori i KS “Partizani” na rikujton se sporti ka qenë dhe mbetet komponent elitar i përgatitjes fizike, morale dhe qytetare të brezave të rinj. Për këtë arsye, do të ishte më se e merituar që në Muzeun e KS “Partizani”, por edhe në Muzeun e Forcave të Armatosura, të ngrihet një stendë e posaçme kushtuar kontributit të skënderbegasve – sportistë dhe trajnerë.

Urim dhe shpresë për të ardhmen

Duke uruar “Gëzuar!” për këtë jubile të rëndësishëm, shprehim dëshirën dhe besimin që emri i “Partizanit” të rifitojë shkëlqimin që ka pasur dhe që e meriton, si simbol i sportit, ushtrisë dhe krenarisë kombëtare shqiptare.

Rekordet

Superliga, 17 herë Kampion

- | | |
|--------|--------|
| • 1947 | • 1963 |
| • 1948 | • 1964 |
| • 1949 | • 1971 |
| • 1954 | • 1979 |
| • 1957 | • 1981 |
| • 1958 | • 1987 |
| • 1959 | • 1993 |
| • 1961 | • 2019 |
| | • 2023 |

Lojtarët e Partizanit me “Këpucën e Artë”

1947, Hamdi Bakalli **7 gola**, 1948, Zihni Gjinali **11 gola**, 1949, Zihni Gjinali **13 gola**, 1950, Loro Boriçi **9 gola**, 1951, Refik Resmja **59 gola**, 1952, Refik Resmja **17 gola**, 1953, Refik Resmja **9 gola**, 1954, Refik Resmja **13 gola**, 1955, Refik Resmja **23 gola**, 1956, Refik Resmja **17 gola**. Panajot Pano **6 gola**, 1961, Panajot Pano **14 gola**, 1961/62, Panajot Pano **17 gola**, 1962/63, Robert Jashari **18 gola**, 1963/64, Robert Jashari **9 gola**, 1964/65, Robert Jashari **14 gola**, 1970/71, Panajot Pano **17 gola**, 1977/78 – Agim Murati **13 gola**, 1978/79, Agim Murati **14 gola**.

Kupa e Shqipërisë

Fitues (15 herë):

- 1948 Partizani 5-2 Tirana
- 1949 Partizani 1-0 Tirana
- 1957 Partizani 2-0 Lokomotiva
- 1958 Partizani 4-0 Skenderbeu
- 1961 Partizani 1-1 1-0 Besa
- 1964 Partizani 3-0 Tomori
- 1966 Partizani 2-1 4-3 Vllaznia
- 1968 Partizani 4-1 Vllaznia
- 1970 Partizani 4-0 0-1 Vllaznia
- 1973 Partizani 1-0 Dinamo
- 1980 Partizani 1-1 1-0 Elbasani
- 1991 Partizani 1-1 4-3 Flamurtari

Finalist (8 herë):

- 1950 Dinamo 2-1 Partizani
- 1951 Dinamo 3-2 Partizani
- 1953 Dinamo 2-0 Partizani
- 1954 Dinamo 2-1 Partizani
- 1974 Dinamo 1-0 Partizani
- 1985 Flamurtari 2-1 Partizani
- 1988 Flamurtari 1-0 Partizani
- 1989 Dinamo 0-0 3-1 Partizani



Partizani – IFK Norrköping (Stadiumi Qemal Stafa, 12.09.1962)



MUNDËSI UNIKE NË FORCËN AJRORE!

Qendra e Personel Rekrutimit shpall rekrutimin e 1 (një) kandidati për “Kursin fillestar të Oficerit të Forcës Ajrore”, që do të zhvillohet në Akademinë Ushtarake Mbretërore, Cranwell (Britani e Madhe), nga **2 shkurt – 11 shtator 2026**.
Një vend. Një mundësi. Një e ardhme në Forcën Ajrore.